



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2019

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mars 2020

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
KORNIZA LIGJORE	8
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	8
<i>Misioni i KPM-së është:.....</i>	<i>8</i>
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL	8
<i>Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së.....</i>	<i>8</i>
<i>Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2019</i>	<i>9</i>
<i>Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2019.....</i>	<i>9</i>
AKTIVITETET E KPM-së.....	10
<i>Mbledhja e parë e KPM-së, e mbajtur më 31 janar 2019.....</i>	<i>10</i>
<i>Mbledhja e dytë e KPM-së, e mbajtur më 22 shkurt 2019</i>	<i>11</i>
<i>Mbledhja e tretë e KPM-së, e mbajtur më 21 mars 2019</i>	<i>11</i>
<i>Mbledhja e katërt e KPM-së, e mbajtur më 29 mars 2019</i>	<i>12</i>
<i>Mbledhja e pestë e KPM-së, e mbajtur më 26 prill 2019.....</i>	<i>13</i>
<i>Mbledhja e gjashtë e KPM-së, e mbajtur më 17 maj 2019</i>	<i>13</i>
<i>Mbledhja e shtatë KPM-së, e mbajtur më 17 qershor 2019.....</i>	<i>14</i>
<i>Mbledhja e tetë KPM-së, e mbajtur më 24 korrik 2019.....</i>	<i>15</i>
<i>Mbledhja e nëntë e KPM-së, e mbajtur më 29 gusht 2019</i>	<i>16</i>
<i>Mbledhja e dhjetë e KPM-së, e mbajtur më 19 shtator 2019.....</i>	<i>17</i>
<i>Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 18 tetor 2019.....</i>	<i>17</i>
<i>Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 4 nëntor 2019</i>	<i>18</i>
<i>Mbledhja e trembëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 12 dhjetor 2019</i>	<i>19</i>
<i>Mbledhja e katërmëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 24 dhjetor 2019.....</i>	<i>20</i>
VAZHDIMI I PUNËS NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE	21
<i>Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së</i>	<i>21</i>
RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT	21
ZHVILLIMET LIDHUR ME PROCESIN E KALIMIT NË TRANSMETIM DIXHITAL TOKËSOR.....	22
<i>Projekti “Matja dhe Planifikimi i Rrjetit për Dixhitalizim të Mediave”</i>	<i>22</i>
<i>Formimi i Grupit Punues për Çështje Teknike për përpilimin e projektit të përbashkët për dixhitalizim të transmetimit tokësor radiodifuziv.....</i>	<i>22</i>
<i>Strategjia për Kalim në Transmetim Dixhital Tokësor në Republikën e Kosovës</i>	<i>24</i>

<i>Memorandumi i bashkëpunimit me Bankën Botërore</i>	24
PUBLIKIMET LIDHUR ME PAJTUESHMËRINË E OSHMA-VE ME AKTET NËNLIGJORE	25
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	25
<i>Bashkëpunimi në kuadër të platformës evropiane të autoriteteve rregullatore (EPRA)</i>	25
<i>Konferenca regjionale e autoriteteve rregullative të medieve, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 – Faza II”</i>	26
<i>Aktivitetet e realizuar në kuadër të programit të BE-së “Asistenca Teknike për Transmetuesit Publik në Ballkanin Perëndimor”</i>	27
<i>Organizimi i punëtorive me nxënës të shkollave të mesme lidhur me Edukimin Medial</i>	27
<i>Bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive të Republikës së Shqipërisë (AMA)</i>	27
ORGANIZMI I TRYEZËS KONSULTATIVE ME MEDIAT E LICENCUARA LIDHUR ME ZGJEDHJET 2019	28
AKTIVITETE NË KUADËR TË EDUKIMIT MEDIAL	29
<i>Organizimi i tryezës me temën “Rregullatorët e mediave dhe edukimi mbi median dhe informacionin (EMI)”</i>	29
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE	30
<i>Burimet njerëzore</i>	30
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)	30
<i>Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale</i>	31
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale</i> ..	31
<i>Monitorimi i parë lidhur me pajtueshmërinë me Rregulloren KPM2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale</i>	32
<i>Monitorimi i dytë lidhur me pajtueshmërinë me Rregulloren për KKAV</i>	32
<i>Pajtueshmëria me të Drejtën e Autorit</i>	32
A. <i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit</i>	32
B. <i>Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë</i>	33
<i>Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve</i>	33
<i>Mediat gjatë zgjedhjeve</i>	34
A. <i>Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan</i>	35
B. <i>Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës</i>	35
<i>Raporti gjinor</i>	35
<i>Ankesat e parashtruara dhe rastet ex officio</i>	36

<i>Vizitat në terren.....</i>	<i>36</i>
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	36
<i>Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës</i>	<i>36</i>
<i>Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara sipas gjuhëve:.....</i>	<i>36</i>
<i>Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:</i>	<i>37</i>
<i>Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes</i>	<i>37</i>
<i>Shqyrtimi i kërkesave</i>	<i>37</i>
<i>Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2019, janë gjithsej 14 raste:.....</i>	<i>38</i>
DEPARTAMENTI LIGJOR	38
<i>Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 për KPM-në.....</i>	<i>38</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM -2017/07.</i>	<i>39</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01</i>	<i>39</i>
<i>Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03</i>	<i>39</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për Tarifën Vjetore për Licencë KPM-2017/06 - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjobat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.....</i>	<i>40</i>
<i>Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01</i>	<i>40</i>
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, neni 49, paragrafi 7, mosjellja e ditarëve.</i>	<i>40</i>
<i>Rastet e shkeljeve gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme.....</i>	<i>41</i>
<i>Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2019, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03</i>	<i>42</i>
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR.....	44
<i>Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....</i>	<i>44</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....</i>	<i>45</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini).....</i>	<i>45</i>
<i>Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal.....</i>	<i>46</i>
<i>Rastet për interferencë</i>	<i>46</i>
<i>Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR.....</i>	<i>46</i>
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE.....	47
<i>Buxheti.....</i>	<i>47</i>
PUNA E BORDIT PËR ANKESA	50

<i>Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa</i>	50
<i>Përbërja e Bordit gjatë vitit 2019</i>	50
<i>Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa</i>	50
RELIZIMI I OBJEKTIVAVE TË VITIT 2019	51
OBJEKTIVAT E VITIT 2020	52
1. <i>Avancimi i kornizës ligjore</i>	52
2. <i>Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”</i>	53
3. <i>Dixhitalizimi i shërbimeve të KPM-së (e-KPM)</i>	53
4. <i>Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror</i>	53
REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT	54
<i>Vështirësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare</i>	54
<i>Nevoja për rritjen e numrit të stafit</i>	54
AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31	
DHJETOR 2018	55
<i>Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)</i>	55

SHTOJCAT

- Shtojca I - Organogrami
- Shtojca II - Tabela e Rasteve Ligjore
- Shtojca IIIa - Raporti Vjetor Financiar
- Shtojca IIIb - Raporti Vjetor Financiar
- Shtojca IV - Raporti “OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019”
- Shtojca V - Raporti “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve, periudha prill-maj 2019”
- Shtojca VI - Raporti “OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan”
- Shtojca VII - Raporti “Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet aktivitetet e Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2019, të cilin ju përcjellim në pajtim me nenin 3, paragrafi 2, pika 8, të Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ashtu siç kërkohet nga Kuvendi, raporti është i ndarë në kapituj ku është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësi të KPM-së.

Raporti i punës së KPM-së për vitin 2019, përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, amandamentimi dhe miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i KPM-së me të licencuarit, bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi me rregullatorët në rajon e më gjerë. Po ashtu, në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele, me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, të dhënat rreth numrit të të licencuarve, rastet ligjore të proceduara, shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës – licencime të reja për radio transmetim, raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin paraprak.

Në mungesë të mbështetjes financiare apo çfarëdo forme tjetër nga Qeveria e Kosovës, edhe për vitin 2020 prioritet i KPM-së mbetet implementimi i procesit të dixhitalizimit sipas Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjit Nr.05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore, zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt, miratimi i strategjisë për dixhitalizim nga Qeveria e Kosovës vazhdon të mbetet prioritet i lartë për zgjidhjen e procesit të dixhitalizimit në vend.

Gjithashtu, harmonizimi i akteve nënligjore dhe hartimi i akteve të reja nënligjore që rrjedhin si obligim nga procesi i dixhitalizimit, në harmoni me rregullativën evropiane si dhe zhvillimi i politikës së transmetimit mbeten prioritet i KPM-së për vitin 2020.

Mars 2020

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

KORNIZA LIGJORE

KPM-ja është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Me nenin 3, paragrafin 2.8, të Ligjit për KPM-në përcaktohet që: *“KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”*.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM-ja është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

Misioni i KPM-së është:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele;
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11, pika 2.1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: *“brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”*

Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2019

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Muja	FERATI	Kryetar ¹	më 30 maj 2018	mandat dy (2) vjeçar
Violeta	HYSENI KELMENDI	Nënkryetare ²	më 17 prill 2018	mandat katër (4) vjeçar
Anita	MURIQI	Anëtare	më 30 maj 2018	mandat dy (2) vjeçar
Maja	SLAVIQ	Anëtare	më 17 prill 2018	mandat tre (3) vjeçar
Vlorë	BERISHA	Anëtare	30 nëntor 2017	mandat tre (3) vjeçar
Xhemajl	KRASNIQI	Anëtar	17 nëntor 2016	mandat katër (4) vjeçar

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet me short në bazë të nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2019

Gjatë periudhës raportuese, i ka skaduar mandati një (1) anëtar të Komisionit. Lidhur me këtë, Zyra Ekzekutive ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në. Bazuar në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.06-V-321, datë 28.02.2019, KPM-ja ka bërë ftesë publike për nominime për një (1) anëtar të KPM-së, nga radhët e komunitetit jo shqiptar në Republikën e Kosovës. Ftesa publike është bërë më 8 mars 2019 deri më 22 mars 2019. Gjatë kësaj periudhe, KPM-ja ka pranuar gjithsejtë katër (4) nominime. Më 26 mars 2019, sipas procedurës, KPM-ja i ka përcjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës të gjitha nominimet e pranuar. Deri në përfundim të vitit 2019, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ka zgjedhur anëtarin/in e shtatë të Komisionit të Pavarur të Mediave.

¹ z. Muja FERATI është zgjedhur Kryetar i KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 21 qershor 2018.

² znj. Violeta HYSENI KELMENDI është zgjedhur Nënkryetare e KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 21 qershor 2018.

AKTIVITETET E KPM-së

Në kuadër të aktivitetit institucional dhe në bazë të obligimeve ligjore, gjatë vitit 2019, KPM-ja ka mbajtur katërbëdhjetë (14) mbledhje të rregullta në të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për KPM-në të cilat janë të paraqitura në këtë raport.

Në vazhdim paraqiten në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur rastet e trajtuara dhe vendimet e marra nga Komisioni gjatë seancave të mbledhjeve të rregullta të vitit 2019.

Mbledhja e parë e KPM-së, e mbajtur më 31 janar 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni ka miratuar Raportin Tremujor tetor – dhjetor 2018, i cili është përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore që kishin të bëjnë shkelje të legjislacionit të KPM-së:

Ankesë nga z.Milaim Sejдини kundër RTK1 për shkelje të Kodit të Etikës – Pas shqyrtimit të rastit ligjor, Komisioni ka vendosur që RTK1 të urdhërohet që në afat prej shtatë (7) ditësh t'i ofrojë Palës Ankuese të drejtën për t'u deklaruar në lidhje me kronikën "Përmirësimet në Arsim", në mënyrë që Palës t'i sigurohet një prezantim objektiv dhe korrekt, ashtu siç përcaktohet me nenin 6, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, si dhe ka vendosur që RTK1 të sanksionohet me gjobë në vlerën prej dymijë (2,000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 6, paragrafi 1 dhe 7, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

TV Vali dhe TV Puls – Pas shqyrtimit të këtyre rasteve ligjore, Komisioni ka vendosur që, për shkelje të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuele, . subjektet e cekura të sanksionohen me masën sanksionuese Vërejtje.

Tribuna Channel – Pas shqyrtimit të rastit ligjor, Komisioni ka vendosur që Tribuna Channel të obligohet të ndërpresë menjëherë transmetimin e përmbajtjeve për të cilat nuk posedon marrëveshje valide të drejtave të autorit dhe të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, siç e përcakton neni 5, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2013/02 si dhe ka vendosur që Tribuna Channel të sanksionohet me gjobë në vlerën prej njëmijë (1,000) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02 për të Drejtën e Autorit në Shërbimet Mediale Audiovizuale.

Tribuna Channel – Komisioni, pas shqyrtimit të rastit ligjor, vendosi që Tribuna Channel të sanksionohet me Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 10, paragrafi 1, dhe nenit 11, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

Gjithashtu, në këtë mbledhje KPM ka shqyrtuar dhe miratuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit:

- Operator i Shpërndarjes EGC – kërkesë për ndërprerje të licencës;

- Operator i Shpërndarjes Intersat – kërkesë për ndërprerje të licencës;
- Operator i Shpërndarjes Drinia Net – kërkesë për ndërprerje të licencës;
- Operator i Shpërndarjes Albi@Net – kërkesë për ndërprerje të licencës;
- Ofrues i Shërbimit Medial Aaudiovizual American TV of Kosova – kërkesë për licencë të OSHMA-së përmes operatorëve të shpërndarjes.

Mbledhja e dytë e KPM-së, e mbajtur më 22 shkurt 2019

Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar tri raste të licencimit, respektivisht kërkesa për ripërtëritje të licencës për këto raste:

- POSITIVE GOLD – Kërkesë për ndryshimin e pronarit si person fizik të OSHMA-ve: Positiv Gold TV, Suite TV dhe Travelingo TV;
- KLAN KOSOVA – Kërkesë për ripërtëritjen e licencës së OSHMA-së;
- PROGRES – Kërkesë për ripërtëritjen e licencës së OSH-së.

Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni ka miratuar kërkesën për ndryshimin e pronarit si person fizik të OSHMA-së dhe dy kërkesat për ripërtëritje të licencës të OSHMA-ve dhe për Operator të Shpërndarjes.

Mbledhja e tretë e KPM-së, e mbajtur më 21 mars 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin Vjetor për periudhën kohore 1 janar 2018 - 31 dhjetor 2018 për punën e KPM-së. Gjithashtu, në këtë mbledhje Komisioni ka miratuar përbërjen e Komisionit Vlerësues, për vlerësimin e aplikacioneve për licenca të reja për radio sipas konkursit të shpallur më 15 shkurt 2019. Ndërsa, lidhur me procedimin e mëtejshëm të punës në procesin e dixhitalizimit, Komisioni ka miratuar formimin e një Komisioni Teknik me përbërje nga KPM, RTK, KTV, TV21, AMPEK (përfaqësues edhe i mediave regjionale) dhe KTTN.

Komisioni ka shqyrtuar dy raste ligjore që kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkeljen e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01. Lidhur me shkeljen e kësaj rregulloreje, Komisioni shqyrtoi dy raste ndaj: 1. IPKO dhe 2. Kujtesa.

Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni ka vendosur të urdhërohen operatorët e shpërndarjes IPKO dhe Kujtesa që në afat prej gjashtë (6) muajsh nga plotfuqishmëria e këtij vendimi të mundësojnë ri-renditjen e kanaleve në listën kryesore të platformës së tyre, siç e përcakton neni 16, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2016/01. Ndërsa, për shkeljen e deritanishme të legjislacionit, Komisioni ka vendosur të sanksionohen subjektet e lartpërmendura me gjobë në vlerën prej pesë mijë (5,000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 16, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

Ankesa e IPKO kundër ARTMOTION – Pas shqyrtimit të rastit të ankesës së parashtruar nga operatori i shpërndarjes IPKO ndaj operatorit të shpërndarjes ARTMOTION, lidhur me ritransmetimin e ngjarjeve sportive të futbollit të Premier Ligës Angleze dhe Ligës Franceze,

Komisioni nuk ka gjetur shkelje të Rregullores KPM-2016/01 nga operatori i shpërndarjes ARTMOTION ndaj së cilës është parashtruar ankesa dhe ka vendosur që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

TV Prizreni –Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni ka vendosur që TV Prizreni të obligohet të ndërpresë menjëherë transmetimin e përmbajtjeve për të cilat nuk posedon marrëveshje valide të drejtave të autorit dhe të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, siç e përcakton neni 5, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2013/02, si dhe për këto shkelje ka vendosur që TV Prizreni të sanksionohet me Vërejtje.

Pas shqyrtimit të rasteve të shkeljeve të nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave për mos-sjellje të Raportit Vjetor nga Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale: Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio Antena, Radio 7, Radio Kent FM, Radio Urban FM, RTK 1, TV Prizreni, Radio Bambus, Radio Helix, Radio Kent FM 2, Radio Borzani, Radio Energji, Radio Kaçaniku, Radio Max, Radio Shqip FM, Radio Fw City, Radio Victoria, Radio Zëri i Pozheranit, Radio Gjilani, TV Vali, Next Television, Kosova MTV, Tribuna Channel, TV Globi, ART, TV Kosova Channel, Olti TV, 1ST Channel, Turbo Channel, RTK 2, RTK 3 News, RTK 4 Art, TV Diaspora, A9 International TV, Click Channel, TVR, TV Dialog, Tele 1 dhe T 7. Komisioni ka vendosur që të licencuarit e lartpërmendur të sanksionohen me Vërejtje dhe që në afat prej dhjetë (10) ditësh të dorëzojnë raportin vjetor për vitin 2017, ashtu siç përcaktohet me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për KPM-në.

Lidhur me shkeljen e Kodit të Etikes për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, Komisioni ka shqyrtuar rastet ligjore për: RTK 1, KTV, TV 21, Klan Kosova, Tribuna Channel dhe TE 7.

Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni ka vendosur që palët përgjegjëse të sanksionohen me Vërejtje si dhe të obligohen që në të ardhmen t'i kushtojnë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të personave të dyshuar në mënyrë që të veprojnë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

Gjithashtu, në këtë mbledhje KPM ka trajtuar dhe ka miratuar disa kërkesa në rastet e licencimit:

- TVN Cable TV – Rekomandim për ndërprerje të licencës së operatorit të shpërndarjes;
- OSHMA News TV – Rekomandim për ndërprerje të licencës, pasi që kjo OSHMA nuk ka parashtruar kërkesë për ripërtëritje të licencës.

Mbledhja e katërt e KPM-së, e mbajtur më 29 mars 2019

Në vazhden e punës në procesin e dixhitalizimit, KPM-ja ka shqyrtuar dhe miratuar Termat e Referencës për Grupin Punues për Çështje Teknike, që ka pasur për qëllim përgatitjen e një projekti të përbashkët për Dixhitalizimin e Transmetimit Tokësor Radiodifuziv në Republikën e Kosovës.

Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesën e AMPEK-ut për ndryshim të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, për periudhën kohore deri më 1 tetor 2019, me të cilën ndryshohet koha e përcaktuar me nenin 11, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2017/07,

ku lejohet llogaritja e kuotës 20% e të transmetimit të komunikimeve komerciale, duke filluar prej orës 17:00 deri në ora 24:00. Komisioni gjithashtu ka marr vendim për zgjatjen e afatit për komente publike për dy draft-rregullore deri më 31 maj 2019, në orën 16:00.

Bazuar në nenin 3, paragrafi 2.9, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe në nenin 30, paragrafi 1 dhe 4, të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, pas skadimit të mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv, Komisioni mori vendim për caktimin e Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv deri në përmbylljen e procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të Kryeshefit Ekzekutiv me mandat ligjor.

Mbledhja e pestë e KPM-së, e mbajtur më 26 prill 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin Tremujor janar – mars 2019 për punën e KPM-së, i cili është përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas procedurës duke u bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar disa kërkesa në rastet e licencimit:

- Amol TV – kërkesë për ripërtëritje e licencës;
- Radio Dodona – kërkesë për ndryshimin i pronësisë;
- RTV Ballkan – ndërprerje e licencës;
- Cinemax 1, Cinemax 2, Life hd, Terra hd dhe Tao Tao – kërkesë për licencim të OSHMA-ve me transmetim përmes OSH-ve;
- Kristal TV – kërkesë për licencim të OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve;
- Isp broadcast – kërkesë për bartjen (transferimin) e licencës.

Pas shqyrtimit të kërkesave, Komisioni i miratoi rekomandimet për të gjitha rastet e licencimit.

Mbledhja e gjashtë e KPM-së, e mbajtur më 17 maj 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar një rast ligjor që kishte të bënte me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkeljen e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës:

Klan Kosova – pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni ka vendosur që Klan Kosova të sanksionohet me Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 7, paragrafi 1 dhe 8, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03. Gjithashtu, me anë të këtij vendimi, Klan Kosova ishte obliguar që gjatë trajtimit të ngjarjeve të ngjashme të ketë kujdes të shtuar dhe të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Komisioni ka shqyrtuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit:

- Emonet - kërkesë për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes;
- Mts DOO - kërkesë për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes;
- Radio 1 Pejë - Rekomandim për lëshimin e licencës së radios – kategori regjionale;

- Radio Urban FM Prizren - kërkesë për licencimin e radios – kategori regjionale;
- Radio Club FM Prishtinë - kërkesë për licencimin e radios – kategori regjionale;
- Radio Kalabria Istog - kërkesë për licencimin e radios – kategori lokale;
- Radio Criteria Obiliq - kërkesë për licencimin e radios – kategori lokale.

Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni i miratoi rekomandimet për dhënie të licencës për Operatoret e Shpërndarjes si dhe rekomandimet për lëshimin e licencës së radios në pesë (5) komuna të Kosovës.

Mbledhja e shtatë KPM-së, e mbajtur më 17 qershor 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar disa kërkesa në rastet e licencimit:

- TV Malisheva – rekomandim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes operatorit të shpërndarjes;
- Radio Zëri i Pozheranit – rekomandim për ndërprerje të licencës;
- Zico TV – rekomandim për ndryshimin e skemës programore;
- Etv – rekomandim për ripërtëritje të licencës;
- Swiss Plus 1 – rekomandim për licencimin e operatorit të shpërndarjes;
- Radio Aktiv – rekomandim për ndryshimin e pronësisë dhe skemës programore;
- Radio Llapi – rekomandim për refuzimin e kërkesës për transferimin e licencës.

Pas shqyrtimit të kërkesave, Komisioni i miratoi rekomandimet për të gjitha rastet e licencimit.

Në relacion me monitorimin e mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve, Komisioni ka shqyrtuar edhe Raportin e Monitorimit të OSHMA-ve gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve lokale të jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Sipas të gjeturave nga monitorimi, është vlerësuar që mediat që e kanë mbuluar këtë fushatë kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të disa rasteve, për të cilat janë ndërmarr veprime ligjore.

Komisioni ka shqyrtuar edhe një shkresë publike nga Oda Ekonomike e Kosovës në lidhje me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale në KPM-2016/1. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, Komisioni ka gjetur si të bazuar kërkesën e Odës Ekonomike të Kosovës përmes të cilës e vë në pah pozitën e pabarabartë dhe diskriminuese të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale në raport me operatorët e shpërndarjes. Komisioni vendosi që Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilët nuk transmetojnë përmes rrjetit tokësorë të lirohen nga lista e bartjes së obligueshme, ndërsa Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim tokësorë (me frekuencë) të mbesin pjesë e bartjes së obligueshme, deri në një vendim tjetër të KPM-së për këtë çështje.

Komisioni ka shqyrtuar edhe një shkresë publike nga përfaqësuesit e shoqërisë civile të romëve kosovarë, gazetarë, studentë dhe intelektualë mbi sulmet e fundit ndaj pjesëtares së komunitetit rom në Kosovë.

Në lidhje me këtë çështje, Komisioni potencoi se ishte duke i përcjell me seriozitet zhvillimet lidhur me raportimet e mediave për sulmet ndaj pjesëtares së komunitetit rom në Kosovë dhe se pas monitorimeve të mediave për këto raportime dhe në rast të gjetjes së shkeljeve eventuale, KPM do të ndërmerri masa ligjore konform legjislacionit në fuqi, me qëllim që të sigurohet pajtueshmëri e plotë me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

Mbledhja e tetë KPM-së, e mbajtur më 24 korrik 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin Tremujor prill – qershor 2019 për punën e KPM-së, i cili është përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas procedurës duke u bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Bazuar në nenin 3, paragrafi 2, pika 11, të Ligjit për KPM-në dhe pas përfundimit të procedurave ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore të KPM-së, pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar “Rregulloren për mbështetjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale me mbulim tokësor lokal dhe regjional”. Komisioni gjithashtu ka shqyrtuar disa ankesa të operatorëve të shpërndarjes ndaj Vendimit të Komisionit lidhur me “Bartjen e Obligueshme”, përmes të cilit ishin përjashtuar nga lista e bartjes së obligueshme Ofruesit e Shërbimeve Mediale të cilët transmetojnë jashtë rrjetit tokësorë të transmetimit (jashtë brezit frekuencor). Pas shqyrtimit, Komisioni ka vendosur që të shfuqizohet Vendimi dhe me qëllim të adresimit të kërkesës së Ofruesve të Shërbimeve Mediale, Komisioni ka vendosur të themelohet një Grup Punues për inicimin e ndryshimit të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore që kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkeljen e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale dhe Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Lidhur me shkeljen e Kodit të Etikës, Komisioni ka shqyrtuar këto raste:

Ankesë nga z. Lulzim Kadriu ndaj KTV - Komisioni vendosi që ankesa të refuzohet si e pabazuar për shkak se KTV ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. .

Klan Kosova, KTV, RTK1, RTK2, TE7, TV21 dhe TV Dukagjini – për shkelje të Kodit të Etikës, gjatë raportimit të aksionit të policisë në veri të shtetit, Komisioni vendosi që këto OSHMA të sanksionohen me Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 7, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe ka vendosur që të obligohen në të ardhmen t’i kushtojnë kujdes të duhur mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të personave të dyshuar.

Klan Kosova, KTV, TE7 dhe TV Dukagjini - për shkelje të Kodit të Etikës, gjatë raportimit të rastit të rrahjes së një gruaje të komunitetit rom, Komisioni ka vendosur që këto OSHMA të sanksionohen me Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 7, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe ka vendosur që të obligohen në të ardhmen t’i kushtojnë kujdes të duhur mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të personave të dyshuar.

TV Most dhe TV Puls – për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet dhe nenit 5, paragrafi 6, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës gjatë

fushatës dhe ditës së zgjedhjeve në veri të vendit, Komisioni vendosi që këto OSHMA të sanksionohen me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në dhe ka vendosur që të obligohen që në të ardhmen t'i kushtojnë kujdes të duhur gjuhës së përdorur gjatë transmetimit.

Komisioni i KPM-së ka trajtuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit, respektivisht kërkesa për ndryshim të emrit dhe kërkesa për licencim të OSHMA-ve me transmetim përmes OSH-ve për 8 kanale nga Albatrade Music&Movie LLC.

Pas shqyrtimit të rasteve, Komisioni vendosi të miratojë kërkesën për ndryshim të emrit nga Radio Drenasi, ndërsa të refuzohet kërkesa për licencim të OSHMA-ve me transmetim përmes OSH-ve për 8 kanale nga Albatrade Music&Movie LLC, për shkak të dorëzimit të pakompletuar të kërkesës dhe mos plotësimit të kriterëve ligjore të përcaktuara sipas Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së.

Mbledhja e nëntë e KPM-së, e mbajtur më 29 gusht 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar disa kërkesa në rastet e licencimit, respektivisht kërkesa për licencë për OSHMA, kërkesa për licencë për Operator të Shpërndarjes - OTT si dhe rekomandimet për vazhdimin e afatit të licencave për 6 TV me transmetim analog. Rastet e shqyrtuara janë të renditura si më poshtë:

- RTV Malisheva 2001 – kërkesë për licencë për OSHMA;
- ARTMOTION SH.P.K – kërkesë për licencë për Operator të Shpërndarjes - OTT;
- Vazhdimi i afatit të licencave për 6 TV me transmetim analog.

Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar të gjitha rekomandimet në rastet e licencimit.

Lidhur me pikën e tretë, me qëllim të vazhdimësisë së aktivitetit të transmetimit të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale të licencuara nga KPM-ja, të cilave u ka përfunduar afati i licencave në transmetimin analog, Komisioni i Pavarur i Mediave ka vendosur që të zgjatet përkohësisht afati i licencave të transmetimit të TV stacioneve me transmetim tokësor analog, licenca e të cilave iu ka skaduar më datën 28 gusht 2019. TV stacionet të cilave iu ka skaduar licenca e KPM-së për transmetim janë: RTK 1, TV 21, KTV, TV Dukagjini, TV Mitrovica dhe TV Festina. Komisioni vendosi që shfrytëzimi i frekuencave në përdorim nga këta të licencuar të jetë i përkohshëm, respektivisht deri në përmbylljen e procesit të kalimit nga transmetimi analog në atë dixhital dhe këta të licencuar të ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, të lëshuar më 28 gusht 2009 dhe të njëjtat mbesin të pandryshuara, përfshirë Kushtet Teknike, Formatin e Programit si dhe Zonën e Mbulimit të të Licencuarve.

Komisioni gjithashtu ka shqyrtuar çështjen e emërimit të Kryeshefit Ekzekutiv. Pas shqyrtimit, Komisioni mori vendim me votim unanim nga të gjithë anëtarët, në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-44, të emërohet z. Luan LATIFI, Kryeshef Ekzekutiv të KPM-së. Vendimi për emërim është marrë duke u bazuar në rezultatet e arritura në konkursin publik për pozitën Kryeshef Ekzekutiv të KPM-së, të organizuar nga Ministria e Administratës Publike (MAP).

Mbledhja e dhjetë e KPM-së, e mbajtur më 19 shtator 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni ka diskutuar lidhur me kërkesat e pranuar për licenca për ofrimin e shërbimeve mediale audio. Në lidhje me këtë çështje, KPM ka bërë vlerësimin mbi nevojën dhe mundësinë e shpalljes së frekuencave të lira në disa komuna të Republikës së Kosovës, ku ishte vlerësuar nëse ka mungesë të shërbimeve mediale audio në nivel lokal dhe regjional, duke përfshirë këtu edhe mungesën e shërbimeve mediale audio në gjuhë të minoriteteve, mungesën e pluralizmit medial apo edhe nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të këtij pluralizmi. Ky vlerësim ishte bërë duke u bazuar në Ligjin për KPM-në, respektivisht nenin 9 të këtij Ligji, i cili përcakton Politikën e Transmetimit në Republikën e Kosovës.

KPM po ashtu ka konfirmuar edhe mundësitë teknike për frekuencat e lira, të cilat janë në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës dhe që të njëjtat mund të dalin në konkurs për dhënien në shfrytëzim kandidatëve të cilët i plotësojnë më së miri kriteret konkurruese. Pas shqyrtimit të këtij vlerësimi, Komisioni ka vendosur që të shpallet konkursi publik për dhënien e licencave të reja për transmetimin e programeve në radio, në pesë (5) komuna të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Istog dhe Han të Elezit.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar planin e punës rreth përgatitjeve dhe organizimit për procesin e monitorimit të mediave gjatë fushatës për zgjedhjet e parakohshme 2019.

Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 18 tetor 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar dhe ka miratuar “Raportin e monitorimit të Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuele gjatë fushatës për zgjedhjet e parakohshme 2019”.

KPM ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave, respektivisht Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale KPM-2016/03, Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele dhe Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, për zbatimin e të cilit është përgjegjës KPM. Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar të gjitha këto raste të shkeljeve ligjoredhe vendosi si në vijim:

- RTK1 - të sanksionohet me masën Vërejtje, për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- KTV - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej dy mijë euro (2000 €), për shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale dhe Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele;
- Klan Kosova - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej tre mijë euro (3000 €), për shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale dhe Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele;
- TV Puls - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej dy mijë euro (2000 €), për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale;

- TV Herc - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej dy mijë euro (2000 €), për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale;
- TV Graçanica - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej dy mijë euro (2000 €), për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale;
- TV Most - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej dy mijë euro (2000 €), për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale;
- Rrokum TV - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej dy mijë euro (2000 €), për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës ;
- TE 7 - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej katër mijë euro (4000 €), për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele;
- TV 21 - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej një mijë euro (1000 €) për shkelje të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele;
- TV Dukagjini - të sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej katër mijë euro (4000 €), për shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele.

Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 4 nëntor 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar disa kërkesa në rastet e licencimit, respektivisht kërkesa për licencimin e OSHMA-ve me transmetim përmes operatorit të shpërndarjes, për ndryshim të pronësisë dhe transferimin e licencës, për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes me platformë IPTV dhe për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes me platformë OTT:

- Comnet A SHPK – kërkesë për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes - platformë IPTV;
- Rrokum TV – kërkesë për ndryshimin e pronësisë dhe transferim të licencës;
- TV ISP Music – vendim për licencimin e OSHMA me transmetim përmes Operatorëve të Shpërndarjes;
- TV ISP Shahirat – vendim për licencimin e OSHMA me transmetim përmes Operatorëve të Shpërndarjes; dhe
- IPTV Shqip – vendim për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes - platforma (aplikacioni) OTT;

Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar të gjitha rekomandimet në rastet e licencimit.

Gjithashtu, në këtë mbledhje Komisioni ka shqyrtuar edhe dy ankesa:

- BIRN kundër RTK, drejtuar Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) lidhur me Zgjedhjet e Përgjithshme 2019, e të cilën ankesë PZAP-ja ia ka përcjellë KPM-së për shqyrtim, sepse sipas vlerësimit të PZAP-së ka vendosur që është kompetencë e KPM-së të merret me ankesën - Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni ka gjetur se RTK 1 nuk kishte

bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, dhe ka vendosur që ankesa e BIRN të refuzohet si e pabazuar.

- ART MOTION ndaj disa operatorëve të shpërndarjes lidhur me të drejtën e transmetimit - Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni nuk ka gjetur shkelje të legjislacionit të KPM-së dhe vendosi që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Mbledhja e trembëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 12 dhjetor 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar disa kërkesa në rastet e licencimit. Këto kërkesa kishin të bënin me ripërtëritje të licencës si dhe kërkesa për licencimin e OSHMA-ve me transmetim përmes operatorit të shpërndarjes:

- Tribuna Channel – kërkesë për ripërtëritje të licencës për OSHMA;
- TV Arta - kërkesë për ripërtëritje të licencës për OSHMA;
- Ekran – Film Buçko – kërkesë për licencim si OSHMA;
- Ekran – Film Autokton - kërkesë për licencim si OSHMA;
- Ekran - Film Apsolut - kërkesë për licencim si OSHMA;
- Ekran - Doku Univers - kërkesë për licencim si OSHMA;
- Ekran – Film Ikon - kërkesë për licencim si OSHMA;
- Ekran – Musicalb - Kërkesë për licencim si OSHMA;
- Ekran – Music Super Hits - kërkesë për licencim si OSHMA; dhe
- Ekran Neës - kërkesë për licencim si OSHMA.

Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar të gjitha rekomandimet në rastet e licencimit.

Komisioni ka shqyrtuar edhe disa raste ligjore që kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale dhe Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni i KPM-së ka ardh në përfundim se të gjitha subjektet e lartpërmendura kanë shkelur legjislacionin e KPM-së dhe vendosi si në vijim:

- Ankesë nga Familja Istogu ndaj KTV – Pas shqyrtimit, Komisioni ka vendosur të kërkohej nga KTV që në afat prej 7 ditësh pas pranimi të këtij vendimi, përmes transmetimit, t'i kërkohej falje palës ankuese për transmetimin e të dhënave personale të gjendjes shëndetësore të djalit të tyre, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 1, pika 2, të Ligjit për KPM-në.
- ART Motion ankesë ndaj operatorit të shpërndarjes Kujtesa Net për ritransmetimin e disa kanaleve turke pa të drejtë të transmetimit – Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi të urdhërohet Kujtesa Net që të ndërpresë menjëherë ritransmetimin e kanaleve turke: A Haber, TGRT Haber, TRT 1, TRT Haber, TRT Turk, TRT Muzik, TRT Belgesel. Ndërsa, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, Komisioni vendosi që Kujtesa Net të sanksionohet me Vërejtje.
- ART Motion ankesë ndaj operatorëve të shpërndarjes për ritransmetimin e kanalit ALSAT-M pa të drejtë të transmetimit: Bledi, Fiberlink, Galaktika, Kadria Net,

Kumanova Cable, Tel Communnications, Telkos, Isp Broadcast dhe Kujtesa Net – Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të urdhërohen operatorët e shpërndarjes të lartcekur që të ndërpresin menjëherë ritransmetimin e kanalit ALSAT M dhe në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, dhe vendosi që Palët Përgjegjëse të sanksionohen me Vërejtje.

Mbledhja e katërbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 24 dhjetor 2019

Në këtë mbledhje, Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar aplikacionet për licencimin e radiove sipas konkursit publik për dhënie e licencave për transmetim në radio, për shtatë (7) lokacione të Republikës së Kosovës: tri (3) frekuenca regjionale në Prishtinë, një (1) frekuencë lokale në Pejë, një (1) frekuencë lokale në Gjakovë, një (1) frekuencë lokale në Istog dhe një (1) frekuencë lokale në Han të Elezit.

Konkursi ishte shpallur më datë 27 shtator 2019 dhe ka qenë i hapur deri më datën 27 tetor 2019. KPM kishte pranuar aplikacionet që kanë ardhur deri në këtë afat, por për shumicën e lokacioneve nuk ka pasur fare aplikacione të dorëzuara. Bazuar në këtë situatë, KPM-ja me qëllim të krijimit të një konkurrence të mirëfilltë në të gjitha lokacionet për ku janë shpallur frekuenca të lira për radio, kishte zgjedhur afatin deri më 8 nëntor 2019. Vlerësimi i aplikacioneve të pranuar brenda afatit të caktuar nga KPM-ja është bërë duke u bazuar në legjislacionin e KPM-së, respektivisht Rregulloren KPM 2014/02 për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM-së. Pas procesit të vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni i ka shqyrtuar rekomandimet e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve, të renditura si më poshtë:

- Radio (kategori regjionale Prishtinë, rekomandim për licencim të radios) AAB Radio;
- Radio (kategori regjionale Prishtinë, rekomandim për licencim të radios) Club FM;
- Radio (kategori regjionale Prishtinë, rekomandim për licencim të radios) Radio Clasic FM;
- Radio (kategori lokale Gjakovë, rekomandim për licencim të radios) Radio Criteria;
- Radio (kategori lokale Pejë, rekomandim për refuzim të kërkesës për licencim të radios);
- Radio (kategori lokale Istog, rekomandim për refuzim të kërkesës për licencim të radios);
- Radio (kategori lokale Hani i Elezit, rekomandim për refuzim të kërkesës për licencim të radios).

Pas shqyrtimit të rekomandimeve për secilin prej rasteve të kërkesave për licencë të radios, Komisioni ka miratuar të gjitha ato aplikacione të cilat i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së, ndërsa, vendosi të refuzojë të gjitha ato kërkesa për licencë, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore.

Në këtë mbledhje, Komisioni diskutoi lidhur me amandamentimin e disa prej rregulloreve të KPM-së. Pas diskutimit, Komisioni parimisht vendosi që prej datës 15 janar 2020, të vendosen në diskutim publik këto draft rregullore:

- Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale;
- Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio dhe Audiovizuale.

VAZHDIMI I PUNËS NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE

Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave ka vazhduar punën edhe gjatë vitit 2019 në amandamentimin e legjislacionit sekondar si dhe hartimin e legjislacionit të ri sekondar në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe realizimit të planeve dhe objektivave vjetore.

Në këtë drejtim, Komisioni i Pavarur i Mediave, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2019, pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore për hartimin e legjislacionit sekondar, ka miratuar “Rregulloren për Mbështetjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale me Mbulim Tokësor Lokal dhe Regjional”.

Bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja ka vendosur në diskutim publik:

- Draft Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës; dhe
- Draft Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale.

KPM u ka bërë ftesë publike përfaqësuesve të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale dhe palëve tjera të interesuara për të ofruar komente me shkrim për draft rregulloret e lartpërmendura, prej datës 9 dhjetor 2019 deri më datë 30 dhjetor 2019. Përveç kësaj, KPM gjithashtu do të organizojë dëgjime publike me palët e interesit gjatë vitit 2020.

RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT

Në kuadër të takimeve të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) për “Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqëri Informativë”, KPM-ja ka marrë pjesë në takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE – Kosovë, mbajtur 8 shkurt 2019 në Bruksel. Gjithashtu, KPM-ja ka marrë pjesë edhe në takimin e dytë të Nën-Komitetit për “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, të mbajtur më 12 dhe 13 qershor 2019 në Prishtinë. Në këto takime, përfaqësuesit e KPM-së kanë raportuar për zhvillimet institucionale, ecurinë e punës dhe vështirësitë e ndryshme që KPM-ja po përballlet në lidhje me plotësimin e kriterëve të BE-së siç janë: përfundimi i procesit të dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radio difuzive, harmonizimi i akteve nënligjore të KPM-së me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMSD), si dhe zbatimin e akteve të reja nënligjore të miratuara nga KPM-ja, e që dalin si obligim nga Ligji për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore.

ZHVILLIMET LIDHUR ME PROCESIN E KALIMIT NË TRANSMETIM DIXHITAL TOKËSOR

Projekti “Matja dhe Planifikimi i Rrjetit për Dixhitalizim të Mediave”

Sipas kërkesës së KPM-së drejtuar Autoritetit Qendror të Prokurimit Publik (AQP) në muajin korrik të vitit 2018, përmes thirrjes për konkurs publik, ORS nga Austria është përzgjedhur nga AQP kompania fituese e cila ka bërë analizimin dhe Planifikimin e Rrjetit për Dixhitalizimin e Medias dhe Planin e Frekuencave për transmetimin digjital televiziv tokësor sipas rekomandimeve të aprovuara në Konferencën e Gjenevës, e cila njihet si RRC-06. Këtë Draft Projekt, ORS ia ka dorëzuar KPM-së më 15 Janar 2019. Në këtë Draft Projekt sipas kriterëve të parashtruara nga KPM, e cila duhet të përcillet në këtë projekt, i gjithë territori i Republikës së Kosovës është në një zonë ndarëse dhe kanalet e transmetimit janë ch46 dhe ch58, si dhe një kanal për transmetuesin publik që ende nuk është specifikuar. Projekti Kryesor përfshin 3 kanale (ch46 dhe ch58 si dhe një kanal për transmetuesin publik) të cekur në projekt, megjithatë matjet dhe planifikimi është kryer në mënyrë të tillë që lejon integrimin dhe përditësimin e kanaleve të reja në mënyrë mjaft të lehtë me anë të shtimit të Headend (Pikës Stacionare Televizive), Transmetuesit dhe Pajisjeve të nevojshme. Kërkesa nga KPM ka qenë që projekti të dizajnohet ashtu që kapaciteti maksimal të mundësojë implementimin e 5-7 multipleksave. Karakteristika minimale për mbulueshmërinë e transmetimit dixhital do të jetë përdorimi i standardit DVB-T2 (EN 302 775) për mbulimin e të paktën 95% të popullsisë së Republikës së Kosovës në tërë territorin e Kosovës. I gjithë territori i Republikës së Kosovës duhet të mbulohet nga një zonë transmisioni (ndarje) me një rrjet të vetëm frekuence (SFN) brenda frekuencave të transmetimit UHF CH21-CH59 (69). Pesë (5) lokacione të cilat aktualisht përdoren për transmetimin analog gjithashtu do të përdoren për transmetimin dixhital pasi ato janë të koordinuara për transmetim me fuqi të lartë (high-power). Megjithatë, për të arritur mbulimin maksimal sipas kërkesës, është shtuar një (1) lokacion shtesë dhe i njëjti është i nevojshëm për të arritur fuqinë e sinjalit të kërkuar për mbulimin e të paktën 95% të popullsisë së Republikës së Kosovës në tërë territorin e Kosovës, gjë që edhe me këtë pikë shtesë kjo nuk është arritur.

Sipas këtij projekti kostoja e përfundimit të kalimit në transmetim dixhital është 12,628,500.00, ku zbatimi i projekteve të tilla zgjat përafërsisht 12 – 18 muaj, pas përfundimit të procedurave të prokurimit-nënshkrimit të kontratës.

Formimi i Grupit Punues për Çështje Teknike për përpilimin e projektit të përbashkët për dixhitalizim të transmetimit tokësor radiodifuziv

Në bazë të vendimit të KPM-së të mbledhjes së mbajtur më 21 mars 2019, është krijuar Grupi Punues për Çështje Teknike. Qëllimi i formimit të këtij Grupi Punues është që të shtyhet përpara procesi i punës së dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radiodifuzive. Grupi Punues për Çështje Teknike në bazë të vendimit të KPM-së, është përgjegjës për vlerësimin e projektit të punuar nga ORS (kompani austriake për transmetime) me qëllim të inkuadrimit të përvojave të kompanive austriake dhe përgatitjen e një draft projekti final të përbashkët ndërlidhur me gjendjen reale në terren lidhur me Dixhitalizim e Transmetimit Tokësor Radiodifuziv në Republikën e Kosovës, si një prej objektivave kryesore të KPM-së për vitin 2019. Grupi Punues për Çështje Teknike në bazë të Termave të Referencës, është i obliguar të përpilojë një raport

final në lidhje më të gjeturat e tyre dhe të njëjtin ta përcjell për trajtim të mëtutjeshëm dhe miratim në Komisionin e KPM-së. Grupi Punues është përbërë prej KPM, RTK, KTV, TV21, AMPEK (mediat regjionale) KTTN, ARKEP dhe MZHE. Ky Grup Punues është kryesuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave dhe rezultat i këtij grupi është hartimi i Projektit teknik të detajuar për mbulim të Republikës së Kosovës me sinjal dixhital. Grupi punues, i përbërë nga ekspertët vendor, ka bërë vlerësimin e këtij projekti nga ORS si dhe projekteve të tjera të porositura nga RTV21 dhe dy projekteve tjera të punuara për RTK-në dhe duke shfrytëzuar përvojat e sjellura nga ata dhe eliminuar të metat që mund të ketë një projekt i punuar nga zyra, ka punuar propozim projektin i cili bazohet plotësisht në këto parime themelore: futjen në shfrytëzim të të gjitha potencialeve ekzistuese, ndërtimin e një rrjeti të vetëm (infrastrukturë të vetme) për tërë Kosovën, inkuadrimin e shërbimeve të ngjashme dhe të nevojave të institucioneve tjera si policia, ushtria, emergjenca civile, telekomi etj. me qëllim të themelimit të një subjekti i cili do të vetëmbahet dhe me qëllim të shfrytëzimit maksimal të kapaciteteve infrastrukturore, humane dhe funksionale. Grupi ka shfrytëzuar përvojat praktike shumëvjeçare të anëtarëve në përbërjen e grupit dhe ka bërë përzgjedhjen me shumë kujdes të pikave të transmetimit për rrjetin primar, fuqinë e projektuar me qëllim të arritjes së efektit maksimal në mbulueshmëri (qëllimi fundamental) dhe vendosja në minimum të efekteve negative (si pasoja sekondare) si ndotja radiaktive, interferencat ndaj shteteve fqinje, lëndimi i natyrës dhe shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese. Në bazë të punës së grupit ka dalë një projekt propozim i cili i ka përfshirë të gjitha kërkesat dhe ka respektuar kriteret e cekura më parë që u tha më sipër dhe paraqet një propozim projekt të kompletuar dhe shumë më lehtë të realizueshëm. Projektin i është nënshtruar një vlerësimi jo formal nga Banka Botërore dhe grupe joformale inxhinierësh ku ka marrë vlerësime pozitive.

Për të arritur mbulueshmërinë e së paku të 95% të popullsisë së Republikës së Kosovës në tërë territorin e Kosovës e në bazë të frekuencave që i janë ndarë në Konferencën Regjionale RRC-06, e organizuar nga ITU në vitin 2006 e që janë shumë pak, 6 frekuenca në UHV (Ch21, Ch231, Ch44, Ch46, Ch48 dhe, Ch58,) dhe një frekuencë në VHF (Ch07) dhe të aprovuara nga KPM-ja në "Strategjinë e kalimit të transmetimit analog në dixhital në Republikën e Kosovës, në kuadër të të cilës përkufizohet principi i punës SFN, për tërë territorin e Republikës së Kosovës, që praktikisht shëndrrohet në një Allotment dhe me 4 Suballotmente regjionale dhe Suballotmentin e posaçëm për Prishtinën si Kryeqytet, projekti parasheh 5 pika kryesore emetuese (Golesh, Zatriq, Maja e Gjellbër, Cërnushë dhe Vneshta). Përveç këtyre pikave kryesore, me këtë projekt parashihen edhe 7 pika tjera emetuese, prej të cilave për shkak të pozitës gjeografike dhe fuqisë së madhe rrezatuese, 4 janë pika që i nënshtrohen principit të punës në SFN (Kranidell, Koliq, Bajrak dhe Gllloboçicë) ndërsa tri pikat tjera emetuese (Budakova, Kodra e Xërxës dhe Brankovo Brdo) për shkak të pozitës gjeografike dhe fuqisë rrezatuese të vogël nuk ka nevojë të hyjnë në SFN. Janë të domosdoshme edhe dy pika tjera të cilat nuk janë emetuese: 1. HUB si pikë kryesore kontributive dhe distributive dhe 2. Butova si pikë e linçeve ndërlidhëse në mes të HUB-it dhe Majës së Gjellbër.

Brenda projektit është paraparë që të përfshihen edhe 17 TV regjionale dhe lokale dhe atë në dy variante dhe në fund është bërë rekapitullimi financiar për implementim të projektit në tërësi, duke përfshirë pajisje rezervë, mjetet të punës si dhe shpenzimet për eksploatimin një vjeçar e që në tërësi arrin vlerën prej: 7,084,635.00 € (Kjo në rastin e shfrytëzimit të një pjese të

infrastrukturës ekzistuese). Në rast se nuk shfrytëzohet infrastruktura ekzistuese, kostoja e projektit rritet për afro 1.5 milion euro.

Strategjia për Kalim në Transmetim Dixhital Tokësor në Republikën e Kosovës

Komisioni i Pavarur i Mediave, më datë 16 dhjetor 2019, ka përcjell për të katërtën herë tek Zyra për Planifikim Strategjik dhe Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dokumentin e Strategjisë për Kalim në Transmetim Dixhital Tokësor në Republikën e Kosovës, dhe derimë tani nuk ka pranuar me shkrim arsyet për mos-aprovim të kësaj strategjie nga ana e Qeverisë. Ky dokument është i harmonizuar nga aspekti i përmbajtjes dhe strukturës edhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012. Në Strategji janë përcaktuar qartë objektivat strategjike dhe ndërlidhja e tyre me planin e veprimit. KPM-ja mbetet në pritje të miratimit të kësaj strategjie në mënyrë që të mund të procedohet tutje, duke i hapur rrugë implementimit të procesit të kalimit në transmetim dixhital tokësor.

Memorandumi i bashkëpunimit me Bankën Botërore

Në vitin 2019, KPM-ja ka arritur një Memorandum Bashkëpunimi me Bankën Botërore për ngritjen e kapaciteteve në relacion me transmetimin dixhital në përgjithësi. Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit me Bankën Botërore, KPM është përfituese e Programit për Shkëmbim Përvojash (Knowledge Sharing Program), që financohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Koresë së Jugut dhe ka të bëjë me mbështetjen për kalim në transmetim dixhital të vendeve në zhvillim. Aktiviteti realizohet nga RAPP (Korea Radio Promotion Association), kompani e përzgjedhur si konsulent i programit, subjekt i njohur për përfaqësim të kalimit dixhital dhe menaxhimin e spektrit në Koren e Jugut.

Në kuadër të këtij programi, përveç ofrimit të programeve për ngritje të kapaciteteve njerëzore për KPM-në nga RAPA në bashkëpunim me Bankën Botërore, parashihet edhe asistencë teknike gjatë procesit të kalimit në transmetim dixhital.

Për të vlerësuar statusin aktual të procesit të kalimit në transmetim dixhital në Kosovë është kryer edhe një raport nga Banka Botërore. Sipas këtij raporti, aktorët kryesorë të identifikuar përfshijnë qeverinë (ministritë përkatëse), rregullatorin, operatorin aktual Televizionin Tokësor Publik, transmetuesit e tjerë, si dhe operatorët e telefonisë mobile. Komiteti aktual i punës i përbërë nga përfaqësues nga MZHE, KPM, transmetuesit dhe telekomi.

Në raport po ashtu është rekomanduar që në rastin e Kosovës, duke pasur parasysh koston dhe përfitimin e investimit, si alternativë që përshtatet me fondet në dispozicion të konsiderohet përdorimi i një stacioni të vetëm transmetimi (në vend të katër) për të mbuluar pjesën më të madhe të vendit (kontrollimi i forcës së sinjalit për të parandaluar ndërhyrjen me vendet e tjera).

Duke marrë parasysh hartën e rrugës dixhitale të qarkullimit të Kosovës, dixhitalizimi në Kosovë mund të kompletohet deri në qershor 2021. Sipas këtij raporti, duke marrë parasysh situatën ekonomike të Kosovës, rekomandohet një rrjet i vetëm i përbashkët, ndërsa për shkak të zonës së vogël (10,887m²), është e përshtatshme që të ndahet një zonë e SNF.

PUBLIKIMET LIDHUR ME PAJTUESHMËRINË E OSHMA-VE ME AKTET NËNLIGJORE

Gjatë vitit 2019, KPM-ja ka publikuar tri (3) Raporte të Monitorimit të OSHMA-ve lidhur me pajtueshmërinë e tyre me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së:

Raporti 1. “OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019”³;

Raporti 2. “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve, periudha prill-maj 2019”⁴;

Raporti 3. “OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan”⁵.

Raportet përmbajnë të gjeturat nga monitorimi i OSHMA-ve, në bazë të së cilave edhe janë dhënë rekomandime për OSHMA-të me qëllim të pajtueshmërisë së tyre me legjislacionin në fuqi.

Këto raporte janë publikuar në ueb faqen e KPM-së si dhe janë shtypur dhe shpërndarë palëve me interes, me qëllim të adresimit të çështjeve që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së.

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi në kuadër të platformës evropiane të autoriteteve rregullatore (EPRA)

Në kuadër të platformës EPRA, anëtare e së cilës KPM është që nga viti 2003, mundësohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me autoritetet evropiane rregullatore për politikën audiovizuale. Ky bashkëpunim realizohet përmes takimeve të rregullta vjetore që organizohen dy herë brenda vitit.

Natyra e konferencave të EPRA-së është e karakterit të shkëmbimit të përvojave në fushën e rregullimit të mediave, në mes të anëtarëve të kësaj organizate, sfidave me të cilat përballen në këtë fushë, si dhe ofrimin e alternativave për zgjidhjen e këtyre sfidave bazuar në përvojat e ndryshme.

Konferenca e parë e EPRA-së është mbajtur në Sarajevë më 30 dhe 31 maj 2019. Ky takim ishte i 49-ti me radhë i takimeve të rregullta të EPRA-së, nikoqir i së cilës kësaj radhe ishte rregullatori i mediave në Sarajevë. Në kuadër të konferencës janë zhvilluar sesione plenare si dhe grupe punuese, në të cilat janë trajtuar tema si:

³ Shtojca IV - Raporti “OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019”

⁴ Shtojca V - Raporti “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve, periudha prill-maj 2019”

⁵ Shtojca VI - Raporti “OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan”

- Mbrojtja e të miturve në botën virtuale “online”;
- Edukimi medial;
- Veprat evropiane; dhe
- Parandalimi i gjuhës së urrejtjes në media në vendet me komunitete multikulturore.

Konferenca e dytë vjetore e EPRA-s është mbajtur në Athinë më 23 dhe 25 tetor 2019. Ky takim ishte i 50-ti me radhë i takimeve të rregullta të EPRA-së, nikoqir i së cilës ishte rregullatori i mediave në Athinë.

Në kuadër të konferencës janë zhvilluar sesione plenare si dhe grupe punuese, në të cilat janë trajtuar tema si:

- Sfidat e përbashkëta me të cilat përballen Autoritetet Kombëtare Rregullatorë dhe Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave në lidhje me fëmijët dhe konsumin e tyre dixhital;
- Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në moderimin e përmbajtjes;
- Edukimi medial;
- Veprat evropiane dhe rëndësia e tyre: identifikimi i praktikave më të mira; dhe
- Mundësia e përdorimit të TV-ve dhe shërbimeve mediatike audiovizuale “video sipas kërkesave”.

Pjesëmarrës në këto konferenca ishin përfaqësuesit e rregullatorëve nga më shumë se 50 vende, anëtarë të EPRA-së, përfaqësues të institucioneve relevante evropiane, përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të ndryshme të cilët merren me fushën e mediave.

Konferenca regjionale e autoriteteve rregullative të medieve, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 – Faza II”

Në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 – Faza II”, më 12 dhe 13 shtator 2019, në Podgoricë të Malit të Zi është organizuar konferenca regjionale për autoritetet rregullatore të mediave. Në këtë konferencë ishin pjesëmarrës përfaqësues nga rregullatorët e regjionit: Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, si dhe përfaqësues nga rregullatori i Kroacisë në cilësinë e mbështetjes me përvojat e tyre si vend anëtar i BE-së. Përfaqësuesit e KPM-së kanë marrë pjesë edhe në konferencën e organizuar nga BE “Ditët e medias në Ballkanin Perëndimor”.

Në konferencë në përgjithësi janë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet e Direktivës për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMSD) dhe obligimeve që mund të kenë rregullatorët pas këtyre ndryshimeve, trendet e rregullimit të Platformave të Shpërndarjes së Videove (Video Sharing Platforms), rëndësinë e harmonizimit të legjisllacionit, pavarësinë e rregullatorëve të mediave dhe çështje që ndërlidhen me fushën e rregullimit të mediave.

Çështjet e diskutuara në këtë konferencë kishin të bëjnë me garantimin e lirisë së mediave dhe qëndrueshmërinë e mediave të pavarura në Ballkanin Perëndimor. Në këtë konferencë, është konfirmuar nga Komisioni Evropian mbështetja e regjionit me iniciativa të reja që fokusohen në

llogaridhënien e mediave, inkurajimin e gazetarëve të rinj, edukimin medial, ekspertizën gjyqësore për lirinë e shprehjes dhe promovimin e bashkëpunimit regional. Në takim është dakorduar edhe për përgatitjet për publikimin e dytë regional që ka të bëjë me çështjen e mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbytjet programore.

Aktivitetet e realizuar në kuadër të programit të BE-së “Asistenca Teknike për Transmetuesit Publik në Ballkanin Perëndimor”

Në kuadër të këtij programi është organizuar një konferencë në Sarajevë/Bosnje dhe Hercegovinë, më 29-30 maj 2019. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi rreth çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin, rregullimin dhe financimin e transmetuesve publik.

Si vazhdimësi e këtij programi, më 18-21 qershor 2019, është organizuar një konferencë në Lubjanë/Sloveni, në të cilën është diskutuar për përcaktimin e parimeve të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor lidhur me financimin e transmetuesve publik.

Në kuadër të këtij programi po ashtu është organizuar një punëtori e nivelit rajonal, në Sarajevë/Bosnje dhe Hercegovinë, më 2 dhe 3 korrik 2019.

Në punëtori janë trajtuar temat që kanë të bëjnë me njohuritë, mjetet dhe udhëzimet për matjet e besueshme të audiencës.

Pjesëmarrës në konferencë kanë qenë përfaqësues të transmetuesve publik dhe rregullatorëve të mediave nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja dhe Hercegovina, si dhe përfaqësues të transmetuesve publik të vendeve të BE-së, anëtarë të EBU-së.

Organizimi i punëtorive me nxënës të shkollave të mesme lidhur me Edukimin Medial

Në kuadër të projektit “JUFREX” të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbajtur dy punëtori me nxënës të shkollave me qëllim të diskutimit të çështjeve që kanë të bëjnë me edukimin medial. Punëtoritë janë mbajtur më 20 dhe 21 nëntor 2019 me nxënësit e shkollës “Xhavit Ahmeti” në Gjilan dhe shkollës “Eqrem Çabej” në Prishtinë. Nxënësit janë njoftuar rreth rolit dhe mandatit të KPM-së si dhe rreth çështjeve që kanë të bëjnë kryesisht me edukimin medial, gazetarinë dhe qytetarinë dixhitale.

Bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive të Republikës së Shqipërisë (AMA)

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 6 mars 2019, ka organizuar vizitë në Autoritetin e Medias Audiovizive (AMA) në Tiranë. Qëllimi i vizitës ishte diskutimi dhe trajtimi i çështjeve me interes të përbashkët të departamenteve përkatëse të rregullatorëve, përfshirë fushëveprimin dhe metodologjinë e përdorur për monitorim të përmbytjeve programore dhe të drejtat e autorit.

Më 3 maj 2019, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit, dhe 20 vjetorit të themelimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) të Republikës së Shqipërisë, një delegacion i Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), i kryesuar nga Kryetari i Komisionit të KPM-së, z. Muja Ferati, dhe U.D. i Kryeshefit Ekzekutiv të KPM-së, z. Luan Latifi, morën pjesë në ngjarjen e shënimit të 20 vjetorit të themelimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) të Republikës së Shqipërisë.

Delegacioni i KPM-së ka zhvilluar takime me Kryetarin e AMA-s, z. Gentian SALA, dhe Prof. Assoc. Dr. z. Mark Marku, Përgjegjës i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në UT, të cilët ishin organizatorë të Konferencës me titullin “Tregu i Medias Audiovizive, sjellja e audiencave dhe kuadri rregullator”. Përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Mediave paraqitën vlerësimin për bashkëpunimin e KPM-së me AMA-në, rolin dhe mandatin e KPM-së në zhvillimet e fundit rreth dixhitalizimit në Kosovë, si dhe rëndësinë e pluralizmit medial në Kosovë. Sfidë që është aktuale nga rregullatorët në përgjithësi është roli i rregullatorëve në relacion me Edukimin Medial, si një platformë e re në fushën rregullimit të mediave. Temat kryesore që u trajtuan në konferencë ishin: tregu i medias dhe operatorët audiovizivë; sjellja e audiencave dhe programacioni; rregullimi dhe vetërregullimi në përgjigje të zhvillimeve teknologjike.

ORGANIZMI I TRYEZËS KONSULTATIVE ME MEDIAT E LICENCUARA LIDHUR ME ZGJEDHJET 2019

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në mbështetje të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), më 18 shtator 2019, organizoi në Prishtinë një takim konsultativ me të gjitha mediat e licencuara nga KPM-ja. Ky organizim kishte për qëllim diskutimin rreth procesit zgjedhor, respektivisht obligimet e mediave sipas Ligjit për Zgjedhje dhe akteve nënligjore të KPM-së. Në takim është prezantuar baza ligjore e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si Kreu VIII i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe legjislacioni i KPM-së, përfshirë Udhëzuesin e KPM-së për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, si dhe rastet e shkeljeve gjatë procesit të zgjedhjeve të mëparshme që u pasua me diskutime me të pranishmit rreth çështjeve që në përgjithësi kanë të bëjnë me obligimet e OSHMA-ve gjatë procesit zgjedhor dhe vështirësitë me të cilat ata ballafaqohen gjatë këtij procesi. Në lidhje me të gjitha pikat e prezantuara më lartë, KPM-ja ka nxjerrë disa rekomandime të cilat dalin nga shkeljet më të shpeshta të identifikuara nga KPM-ja dhe të cilat do të mund dhe duhet t’u shërbejnë mediave që në të ardhmen të veprojnë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Rekomandimet e KPM-së në pika të shkurta kanë të bëjnë me: evitimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme, respektimin e heshtjes zgjedhore, ofrimin e hapësirës së balancuar për të gjithë subjektet politike dhe kandidatëve si dhe evitimin e prezencës e fëmijëve në spotet e subjekteve politike. Ndërsa, sipas OSHMA-ve në përgjithësi, faktori kryesor që ndikon në shkeljet gjatë fushatës zgjedhore është koha e shkurtër e fushatës aktuale të tanishme, që paraqet vështirësi të mbulimit të aktiviteteve në mënyrë proporcionale të SPC-ve, si dhe burimet teknike dhe njerëzore të pamjaftueshme të OSHMA-ve për të ofruar mbulim sa më gjithëpërfshirës të aktiviteteve zgjedhore. Sfidë tjerë për mediat mbetet pozita e pafavorshme në raport me mediat online sa i përket rregullimit si dhe rastet e ndikimeve të OSHMA-ve fqinje gjatë proceseve zgjedhore përmes platformave të operatorëve të shpërndarjes në të cilat janë të pranishme në vendin tonë. Në fund të takimit, përfaqësuesit e KPM-së u shprehën se rregullatori i mediave është në dispozicion dhe i gatshëm në ofrimin e këshillave dhe asistencës së nevojshme për OSHMA-të ndaj vështirësive në punën e tyre dhe problemet të cilat ata i hasin gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre.

AKTIVITETE NË KUADËR TË EDUKIMIT MEDIAL

Organizimi i tryezës me temën "Rregullatorët e mediave dhe edukimi mbi median dhe informacionin (EMI)"

Gjatë Javës Globale për Edukimin mbi Median dhe Informacionin, javë kjo që shënohet çdo vit nga UNESCO, Komisioni i Pavarur i Mediave në bashkëpunim me Institutin për Politika Zhvillimore (INDEP), më 28 tetor 2019, organizuan një tryezë diskutimi me temë 'Rregullatorët e mediave dhe edukimi mbi median dhe informacionin (EMI)'. Qëllimi i tryezës ishte që në kuadër të Javës Globale për EMI, aktorët të mund të paraqesin pikëpamjet e veta lidhur me edukimin mbi median si dhe të diskutohet progresi i shënuar në këtë fushë. Në këtë tryezë u diskutua nga pjesëmarrësit për funksionimin e medias, mungesën e një politike në nivel vendi për edukimin medial, draft Ligjin për KPM-së që është në procedurë të amandamentimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, e ku planifikohet që KPM-ja të merr kompetenca dhe obligime ligjore të përcaktuara qartë, që të zhvillojë aktivitete në këtë fushë.

Gjithashtu, në këtë tryezë u diskutua edhe për format dhe aktivitetet në të cilat mund të angazhohen aktorë të ndryshëm në rritjen e vetëdijes së qytetarëve për edukimin medial, mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në media, fuqizimin e përdoruesve të medias përmes zhvillimit të mendimin kritik për mesazhet që përçohen përmes mediave, adresimin e sfidave të rregullimit, përkatësisht amandamentimi dhe hartimi i legjislacionit krahas ndryshimeve të hovshme teknologjike dhe në harmoni me legjislacionin e BE-së.

PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv, e cila e ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, Kryeshefi Ekzekutiv menaxhon:

- me nëpunësit civilë të KPM-së;
- me financat dhe me burimet tjera të financimit;
- ofron këshilla për politikat e KPM-së;
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive; dhe
- bën koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë katër (4) departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Departamenti i Administratës⁶:

- Departamenti i Monitorimit dhe Analizës;
- Departamenti i Licencimit;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti për Menaxhim Frekuencor; dhe
- Departamenti i Administratës.

Burimet njerëzore

Personeli i Zyrës Ekzekutive janë shërbyes civilë dhe janë të miratuara gjithsej 39 pozita deri në vitin 2019. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në Zyrën Ekzekutive, proces ky që është filluar gjatë vitit 2018, pritet të arrijë të rrisë edhe efikasitetin në punën dhe përgjegjësitë e KPM-së në kuadër të zgjerimit të fushës së kompetencës dhe trendit në rritje të numrit të të licencuarve.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA), gjatë vitit 2019, ka vlerësuar pajtueshmërinë e të licencuarve me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe rregulloret e KPM-së, ndërsa gjatë periudhës së zgjedhjeve, përfshirë ato lokale dhe të përgjithshme, është vlerësuar pajtueshmëria e tyre në bazë të dispozitave ligjore të parapara në Ligjin për Zgjedhjet.

Rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra dhe realizimit të aktiviteteve të poshtëshënuara, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të Zyrës Ekzekutive të KPM-së kanë mbështetur veprimet e mëtutjeshme.

⁶ Shtojca I – “Organogrami”

Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale

Qëllimi i monitorimit të përmbajtjeve programore të OSHMA-ve ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me aktet nënligjore të KPM-së, sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së, përfshirë këtu: Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, KKPM-2016/03 Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale.

Lidhur me këtë, është realizuar monitorimi i OSHMA-ve me transmetim tokësor dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik që operojnë përmes OSH-ve, për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me aktet nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Vlerësimi dhe analizimi është fokusuar në identifikimin e programeve me përmbajtje të dëmshme, që sipas akteve nënligjore në mes tjerash i referohen programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijëve, kohën e transmetimit të përmbajtjeve të tilla programore, paralajmërimit dhe përdorimit të shenjave përkatëse të përcaktuara. Po ashtu, vlerësimi dhe analizimi është bërë edhe në rastet kur fëmijët apo të miturit kanë qenë të përfshirë apo prezentë në përmbajtje të caktuara programore.

Mosta e monitorimit është zgjedhur në mënyrë rastësore, që ka përfshirë datat: 21, 23, 26, 27 tetor 2019 dhe 04, 06, 09, 10 nëntor 2019. Në monitorim janë përfshirë pesëmbëdhjetë (15) OSHMA:

- Tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: RTK 1, KTV dhe RTV 21;
- Tetë (8) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional: TV Besa, TV Dukagjini, TV Mitrovica, TV Most, TV Opinion, TV Prizreni, TV Puls dhe TV Vali;
- Katër (4) OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes: RTK2, Klan Kosova, Rrokum TV dhe TE7.

Raportin e plotë mund ta gjeni në shtojcën VII.

Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale

Çështjet që kanë të bëjnë me transmetimin e komunikimeve komerciale audiovizuale në shërbimet mediale audiovizuale janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në si dhe Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale.

Lidhur me këtë, DMA ka bërë monitorimin e OSHMA-ve (TV) me transmetim tokësor nacional, regjional dhe lokal si dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me Rregulloren në fuqi, në dy periudha kohore gjatë vitit 2019. Një prej tyre ka filluar në vitin 2018 dhe ka përfunduar në janar të vitit 2019 dhe një është realizuar në tetor të vitit 2019.

Monitorimi i parë lidhur me pajtueshmërinë me Rregulloren KPM2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale

Periudha monitoruese ka përfshirë periudhën kohore tre (3) ditore, të përzgjedhur në mënyrë rastësore nga muaji tetor i vitit 2018 dhe ka përfunduar në janar të vitit 2019.

Vlerësimi i pajtueshmërisë së OSHMA-ve me këtë rregullore është fokusuar në: përmbajtjen e komunikimeve komerciale audiovizuale, produktet dhe shërbimet e reklamuar, ndikimin e tyre tek fëmijët dhe të miturit (sipas nenit 9 dhe nenit 16); orarin e transmetimit të KKAV-ve dhe teleshoppingut për produkte të caktuara (sipas nenit 10); mënyrat e reklamimit (sipas nenit 12); format e reklamimit si: sponsorizimi i programeve për fëmijë (sipas nenit 14) dhe vendosja e produkteve (sipas nenit 15) si dhe dispozita tjera të kësaj Rregulloreje.

Mostra e monitorimit ka përfshirë 22 OSHMA, prej tyre:

- Tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: RTK1, KTV dhe TV21;
- Dymbëdhjetë (12) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional: TV Besa, TV Festina, TV Iliria, TV Mitrovica, TV Puls, TV Herc, TV Liria, TV Most, TV Prizreni, TV Syri Vision, TV Vali dhe TV Mir; dhe
- Shtatë (7) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes: RTK2, Rrokum TV, Klan Kosova, Tribuna Channel, TV Kim, 1st Channel dhe TV Kiss.

Monitorimi i dytë lidhur me pajtueshmërinë me Rregulloren për KKAV

Periudha monitoruese ka përfshirë periudhën kohore tre (3) ditore, prej 21 deri më 23 tetor 2019, të përzgjedhur në mënyrë rastësore, ndërsa koha e monitorimit ka përfshirë periudhën nga ora 16:00 deri 24:00. Fokus i monitorimit kanë qenë emisionet informative, debatet dhe emisionet me aktualitete.

Mostra e monitorimit ka përfshirë pesëmbëdhjetë (15) OSHMA, prej tyre:

- Tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: RTK1, KTV dhe TV21.
- Tetë (8) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional: TV Most, TV Opinion, TV Vali, TV Mitrovica, TV Puls, TV Dukagjini, TV Prizreni dhe TV Besa.
- Katër (4) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes: RTK2, Rrokum TV, TE7 dhe Klan Kosova.

Pajtueshmëria me të Drejtën e Autorit

Çështjet që kanë të bëjnë me transmetimin dhe ritransmetimin e përmbajtjeve programore në shërbimet mediale audiovizuale, janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit (e aplikueshme për OSHMA) dhe Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (e aplikueshme për OSH-të).

A. Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit

Lidhur me këtë, DMA ka bërë monitorimin e OSHMA-ve (TV) me transmetim tokësor nacional, regjional dhe lokal si dhe OSHMA-të me karakter gjeneralistik që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me Rregulloren në fuqi.

Monitorimi ka përfshirë periudhën kohore tre (3) ditore, të përzgjedhur në mënyrë rastësore nga muaji tetor i vitit 2018 deri në janar të vitit 2019.

Mostra e monitorimit ka përfshirë 22 OSHMA, prej tyre:

- Tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: RTK1, KTV dhe TV21;
- Dymbëdhjetë (12) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional: TV Besa, TV Festina, TV Iliria, TV Mitrovica, TV Puls, TV Herc, TV Liria, TV Most, TV Prizreni, TV Syri Vision, TV Vali dhe TV Mir; dhe
- Shtatë (7) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes: RTK2, RrokumTV, Klan Kosova, Tribuna Channel, TV Kim, 1st Channel dhe TV Kiss.

Lidhur me transmetimin e programeve të caktuara dhe me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, OSHMA-ve të monitoruara u janë kërkuar marrëveshjet valide për të drejtën e autorit, të cilat janë vlerësuar nga Departamenti Ligjor i KPM-së lidhur me vlefshmërinë e tyre.

B. Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë

Në fillim të vitit 2019, OSH-ve u është kërkuar të deponojnë në KPM katalogët e azhurnuar të kanaleve, marrëveshjet e reja për të drejtat e ritransmetimit të këtyre kanaleve dhe përmbajtjeve programore. Nga ky aktivitet janë siguruar të dhëna të përditësuara në lidhje me të drejtat e ritransmetimit të Operatorëve të Shpërndarjes si dhe oferta e tyre programore për qytetarët.

Gjatë vitit 2019, DMA-ja ka kryer 49 monitorime të ndryshme lidhur me pajtueshmërinë e Operatorëve të Shpërndarjes, prej tyre janë gjetur 29 raste të shkeljeve, ndërsa 20 raste janë gjetur në pajtueshmëri. Nga ky numër, gjashtëmbëdhjetë (16) monitorime janë bërë në bazë të ankesave nga industria mediale. Këto ankesa për subjekt trajtimi kishin pajtueshmërinë e një numri të konsiderueshëm të Operatorëve të Shpërndarjes, por edhe operimeve ilegale pa licencë të KPM-së. Lidhur me këto raste, DMA në bashkëpunim edhe me departamentet tjera, ka realizuar monitorime në terren në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke verifikuar rastet e tilla, dhe më pas duke ndërmarrë veprime konkrete varësisht nga natyra e rasteve.

Raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e gjetura të Operatorëve të Shpërndarjes janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm te Departamenti Ligjor.

Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve

Duke pas parasysh rolin e mediave në përgjithësi, e në veçanti ndikimin e lajmeve në të gjitha aspektet shoqërore në përgjithësi, DMA-ja ka realizuar monitorimin e lajmeve qendrore të ofruara nga të licencuarit e KPM-së, me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve që ofrohen për qytetarët e Kosovës.

Vlerësimi dhe monitorimi i përmbajtjeve të edicioneve qendrore të lajmeve është bërë për periudhën kohore dy (2) mujore, duke përfshirë muajin prill dhe maj të vitit 2019. Mostra e monitorimit ka përfshirë shtatë (7) OSHMA, prej tyre:

- Tre (3) OSHMA me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21 dhe KTV);
- Një (1) OSHMA me mbulim tokësor lokal (TV Dukagjini); dhe

- Tre (3) OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Klan Kosova dhe TE7).

Përmbajtja e monitoruar është ndarë sipas kategorive/temave dhe nënkategorive nga fusha të ndryshme shoqërore. Monitorimi është fokusuar në vlerësimin e relevancës së lajmeve, saktësinë, mbulimin e balancuar, mënyrën e prezantimit të kronikës dhe trajtimit, përfshirë paanshmërinë në zgjedhjen e gjuhës dhe imazheve.

Raportin e plotë mund ta gjeni në shtojcën V.

Mediat gjatë zgjedhjeve

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i cili vlen edhe për zgjedhjet lokale.

Gjatë vitit 2019, në Republikën e Kosovës janë mbajtur dy palë zgjedhje, ato lokale të mbajtura më 19 maj 2019 për kryetar të komunave në veri të vendit dhe zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura më 6 tetor të vitit 2019.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, i cili në është një interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje.

Lidhur me këtë, DMA ka realizuar monitorimin e OSHMA-ve gjatë zgjedhjeve me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së tyre me Kreun VIII të Ligjit të Zgjedhje, përfshirë Udhëzuesin e KPM-së për Zgjedhjet dhe aktet tjera nënligjore respektive të KPM-së.

Fokus i monitorimit ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, spotet politike, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Gjatë periudhës monitoruese është vlerësuar: paanshmëria në raportim, hapësirën e ofruar për SCP-të, gjuha e përdorur dhe në përgjithësi pajtueshmëria me Udhëzuesin e KPM-së për Zgjedhjet dhe aktet tjera nënligjore respektive të KPM-së.

Ndërsa, gjatë zgjedhjeve të përgjithshme, para fillimit të fushatës, më 18 shtator 2019, KPM-ja në mbështetje edhe të OSBE-së, ka organizuar takim konsultativ me të licencuarit e KPM-së, me qëllim të diskutimit rreth procesit zgjedhor, përkatësisht obligimet e mediave sipas Ligjit për Zgjedhje dhe akteve nënligjore të KPM-së. Në takim janë prezantuar shkeljet më të shpeshta të gjetura nga KPM-ja gjatë proceseve zgjedhore të kaluara, me qëllim të evitimit të tyre në këto zgjedhje.

Përmes njoftimeve për media, KPM ka kërkuar nga të licencuarit të veprojnë në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm gjatë procesit zgjedhor, duke ftuar të licencuarit të kontribuojnë me profesionalizëm në mbulimin e procesit zgjedhor. Gjithashtu, përfaqësuesit e KPM-së kanë dhënë disa intervista në disa OSHMA me qëllim të ofrimit të sqarimeve të detajuara sa i përket

raportimit gjatë periudhës së zgjedhjeve në përgjithësi, e në veçanti gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore.

A. Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

Monitorimi ka përfshirë periudhën prej 13–19 maj 2019, në të cilën janë përfshirë nëntë (9) OSHMA, prej të cilëve:

- Tre (3) OSHMA me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Tre (3) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional të Regjionit të Mitrovicës (TV Mitrovica, TV Mir dhe TV Most);
- Një (1) OSHMA me mbulim tokësor regjional i Regjionit të Gjilanit (TV Puls); dhe
- Dy (2) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2 dhe TV Kiss).

Raportin e plotë mund ta gjeni në shtojcën VI.

B. Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

Monitorimi ka përfshirë periudhën prej 25 shtator deri më 6 tetor 2019, në të cilën janë përfshirë shtatëmbëdhjetë (17) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, prej të cilëve:

- Tre (3) OSHMA me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Nëntë (9) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Dukagjini, TV Puls, TV Herc, TV Opinion, TV Besa, TV Vali, TV Most, TV Mitrovica dhe TV Iliria); dhe
- Pesë (5) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Klan Kosova, TE7, Rrokum TV dhe TV Gracanica).

Raportin e plotë mund ta gjeni në shtojcën IV.

Raporti gjinor

Gjatë realizimit të aktiviteteve të DMA-së në monitorimin e OSHMA-ve lidhur me pajtueshmërinë me aktet nënligjore të KPM-së, nga të dhënat e grumbulluara janë nxjerr edhe disa të dhëna sa i përket raportit gjinor në OSHMA.

Gjatë vlerësimit të edicioneve qendrore të lajmeve nga DMA-së, për periudhën kohore dy (2) mujore, duke përfshirë muajin prill dhe maj të vitit 2019, në të cilën janë përfshirë shtatë (7) OSHMA, është përcaktuar që të nxirren të dhëna sasiore sa i përket numrit të moderimit/udhëheqjes dhe editimit/redaktimit të lajmeve në bazë të gjinisë si dhe hapësirës së dhënë në kategorinë e sportit sipas gjinisë, të cilat janë prezantuar në Raportin e Monitorimit “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve”⁷.

Ndërsa, gjatë monitorimit të periudhës së fushatës së zgjedhjeve të përgjithshme, që ka përfshirë periudhën prej 25 shtator deri më 4 tetor 2019, në të cilën janë përfshirë shtatëmbëdhjetë (17) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, janë nxjerr edhe të dhënat sa i përket përfaqësimit gjinor në debate dhe intervista. Këto të dhëna janë prezantuar në Raportin e Monitorimit

⁷ Shtojca V - Raporti “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve, periudha prill-maj 2019”

“OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019”⁸.

Ankesat e parashtruara dhe rastet ex officio

Gjatë vitit 2019, DMA-ja ka pranuar dhe shqyrtuar trembëdhjetë (13) ankesa lidhur me KKPM-2016/3 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, prej tyre shtatë (7) ankesa kanë rezultuar si të pabazuara dhe në tre (3) raste OSHMA-të kanë ardh në pajtueshmëri.

Ndërsa, DMA-ja ka iniciuar njëzet e dy (22) ankesa ex officio për të cilat është pretenduar se ka pasur shkelje gjatë transmetimit të përmbajtjeve të caktuara programore, prej tyre shtatëmbëdhjetë (17) kanë rezultuar në shkelje dhe pesë (5) në pajtueshmëri.

Në përgjithësi, shkeljet kishin të bëjnë me përmbajtjen e dëmshme dhe fyese, nxitje të urrejtjes, paanshmërinë dhe saktësinë e lajmit, të drejtat individuale dhe të drejtën për përgjigje ndaj palëve ankuese.

Vizitat në terren

Në dhjetor të vitit 2019, DMA-ja në bashkëpunim me departamentet përkatëse ka realizuar disa vizita në terren, me qëllim të vlerësimit të gjendjes në aspektin e transmetimit analog të ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele. Vizitat janë kryer tek OSHMA-të që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit: TV Prizreni, TV Opinion, TV Besa, TV Iliria, TV Liria, TV Festina, TV Zoom, TV Mitrovica, TV Mir dhe TV Most.

Vizitat në terren janë realizuar edhe lidhur me pajtueshmërinë e OSH-ve me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë si dhe në rastet e ankesave për veprimtari ilegale të OSH-ve.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së.

Gjatë vitit 2019 kanë operuar gjithsej 19 TV Stacione, 86 Radio Stacione, 41 Operator të Shpërndarjes dhe 97 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes.

Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara sipas gjuhëve:

Të licencuara 19 TV stacione:

⁸ Shtojca IV - Raporti “OSHMA-të gjatë fushatës për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019”

- 1 TV stacion publik;
- 13 TV stacione në gjuhën shqipe;
- 5 TV stacione në gjuhën serbe.

Të licencuara 86 radio stacione:

- 2 radio stacione të transmetuesit publik;
- 53 radio stacione në gjuhën shqipe;
- 22 radio stacione në gjuhën serbe;
- 3 radio stacione në gjuhën boshnjake;
- 2 radio stacione në gjuhën turke;
- 2 radio stacione në gjuhën gorane;
- 1 radio stacion në gjuhën rome;
- 1 radio stacion multietnik.

Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:

Të licencuar 41 operatorë të shpërndarjes

- 34 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë shqiptar;
- 1 operator të shpërndarjes të licencuar me pronarë boshnjak;
- 1 operator të shpërndarjes të licencuar me pronarë goran;
- 5 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë serb.

Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes

Gjithsej janë të licencuar 97 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit të operatorëve të shpërndarjes:

- 86 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- 8 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën serbe;
- 3 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art).

Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2019, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 67 raste për shqyrtim, e të cilat kishin të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHMA-ve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, kërkesa për licencë të operatorëve të shpërndarjes, kërkesa për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesa për ndryshim të pronësisë, kërkesa për ripërtëritje të licencës, njoftime për heqje dorë nga licenca, kërkesa për ndryshim të skemës programore si dhe raste të tjera që lidhen me kushtet dhe termet e përgjithshme dhe ato teknike të licencës së KPM-së.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2019 janë marrë këto vendime për licencim:

- 19 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes;
- 6 vendime për licencimin e operatorëve të shpërndarjes;
- 7 vendime për ripërtëritje të licencës;
- 6 vendime për ndërprerje të licencës (pas njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga licenca e KPM-së);
- 5 raste për ndryshim të pronësisë;
- 1 vendim për ndërprerje të licencës (ex officio);
- 1 vendim për ndryshim të skemës programore;
- 1 vendim për ndryshimin e emrit.

Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2019, janë gjithsej 14 raste:

- 8 raste për ndërprerje të transmetimit;
- 4 kërkesa për heqje dorë nga licenca;
- 1 kërkesë për licencë të operatorit të shpërndarjes;
- 1 kërkesë për zgjerim të mbulimit – frekuencë shtesë.

Gjatë vitit 2019, KPM ka shpallur dy konkurse publike për frekuenca të lira të radios, për shtatë (7) lokacione të Republikës së Kosovës: tri (3) frekuenca regjionale në Prishtinë, një (1) frekuencë lokale në Pejë, një (1) frekuencë lokale në Gjakovë, një (1) frekuencë lokale në Istog dhe një (1) frekuencë lokale në Han të Elezit. Të drejtë konkurrimi kanë pasur të gjithë të interesuarit për licenca të radios, duke dorëzuar aplikacione të plotësuar në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Përmes këtyre konkurseve publike për frekuenca të lira të radios janë licencuar tetë (8) radio stacione të reja, nga të cilat pesë (5) radio me mbulim regional dhe tri (3) radio me mbulim lokal.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar raste të ndryshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale dhe Operatorëve të Shpërndarjes për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër OSHMA-ve dhe OSH-ve.

Rastet e proceduara në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit për KPM-në dhe akteve nënligjore të KPM-së⁹ janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 për KPM-në

Gjatë vitit 2019, Departamenti Ligjor ka proceduar një (1) rast për shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas

⁹ Shtojca II - “Tabela e Rasteve Ligjore”

kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”, dhe nenit 30, paragrafi 5, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: “Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”.

Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Njoftim për Shkelje Operatorit të Shpërndarjes COM NET për operim ilegal. Ky operator ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri për t’u pajisur me licencë të KPM-së dhe si rezultat i kësaj këtij operatori i është konfiskuar aparatura përkatëse për transmetim nga KPM-ja. Pas konfiskimit të aparaturës nga KPM-ja, Operatori i Shpërndarjes COM NET është pajisur me licencë të KPM-së.

Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM -2017/07

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka proceduar pesë (5) raste kundër OSHMA-ve që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07. Të gjitha këto subjekte kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Nëse këto subjekte në të ardhmen dështojnë të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM-2017/07, atëherë Departamenti Ligjor do t’i rekomandojë Komisionit shqiptimin e masave më të ashpra sanksionuese në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së, dhe si raste ligjore janë mbyllur.

Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM- 2013/01

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka proceduar gjashtë (6) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01. Të gjitha këto subjekte kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Edhe pas pranimit të Njoftimeve për shkelje të gjitha këto OSHMA kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01, dhe për këtë si raste ligjore barten për vitin 2020 për procedim të mëtutjeshëm nga Komisioni i KPM-së.

Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka proceduar njëzet (20) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Të gjitha këto subjekte kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Edhe pas pranimit të Njoftimeve për shkelje pesëmbëdhjetë (15) nga këto OSHMA kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Lidhur me këtë, Komisioni, pas rekomandimeve të Departamentit Ligjor për shkeljet e Kodit KKPM 2016/03, i ka dënuar këto OSHMA me masën sanksionuese *Vërejtje* dhe si raste ligjore janë mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores për Tarifën Vjetore për Licencë KPM-2017/06 - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjobat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 i ka dërguar në përmbarrim njëqind e tridhjetë e pesë (135) Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2019. Po ashtu, në përmbarrim janë dërguar edhe shtatëmbëdhjetë (17) raste për mospagesë të gjobave të shqiptuara nga Komisioni i KPM-së.

Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01

Departamenti Ligjor, gjatë vitit 2019, ka proceduar tridhjetë e pesë (35) raste të shkeljeve dhe ankesave të Operatorëve të Shpërndarjes (OSH).

Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftime për shkelje gjashtëmbëdhjetë (16) OSH-ve. Pas Njoftimeve për shkelje, pesëmbëdhjetë (15) prej OSH-ve kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur. Ndërsa, për një OSH i cili ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2016/01 në bazë të Rekomandimeve të Departamentit Ligjor, i është rekomanduar Komisionit të KPM-së ndërmarrja e masave sanksionuese dhe si rast ligjor bartet për vitin 2020 për procedim të mëtutjeshëm nga Komisioni i KPM-së.

Departamenti Ligjor ka proceduar edhe nëntëmbëdhjetë (19) raste në bazë të ankesave të Operatorit të Shpërndarjes Artmotion, dy (2) prej tyre kanë qenë përgjigje në ankesë për Operatorin e Shpërndarjes Artmotion lidhur me ankesat e parashtruara ndaj OSH IPKO dhe J@b Net dhe si raste ligjore janë mbyllur. Pas Njoftimeve për shkelje, shtatë (7) prej OSH-ve kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur.

Komisioni, pas rekomandimeve të Departamentit Ligjor për shkeljet e Rregullores KPM-2016/01, me masën sanksionuese *Vërejtje* ka dënuar dhjetë (10) OSH: Kujtesa Net, Telkos, Galaktika, Bledi, Telcommunication, ISP Broadcast, Kadria Net, Kumanova Cable Fiberlink për transmetim të kanalit ALSAT M, pa të drejtë transmetimi dhe Kujtesa Net për transmetim të kanaleve turke pa të drejtë transmetimi. Komisioni mori Vendim që të gjithë këta OSH të ndërprerësin menjëherë ritransmetimin e kanalit ALAST-M dhe kanalet turke. Rastet janë mbyllur.

Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, neni 49, paragrafi 7, mosjellja e ditarëve.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka proceduar njëzet (20) raste lidhur me shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet, përkatësisht nenit 49, paragrafi 7, mosjellja e ditarëve për Zgjedhjet e Përgjithshme. Të gjitha këto subjekte kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Edhe pas pranimit të Njoftimeve për shkelje, gjashtëmbëdhjetë (16) nga këto OSHMA kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me nenin 49, paragrafi 7, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, dhe për këtë si raste ligjore barten për vitin 2020 për procedim të mëtutjeshëm nga Komisioni i KPM-së.

Rastet e shkeljeve gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme

Departamenti Ligjor, gjatë vitit 2019, ka proceduar njëmbëdhjetë (11) raste lidhur me shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, Kodit të Etikës KKPM 2016/03 si dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audivizuele KPM -2017/07 lidhur me Zgjedhjet e Përgjithshme.

Për të gjitha këto shkelje të OSHMA-ve, Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftime për shkelje. Rastet të cilat kanë ardhur në pajtueshmëri janë mbyllur. Ndërsa për rastet të cilat kanë vazhduar të jenë në shkelje, Departamenti Ligjor i ka rekomanduar Komisionit të KPM-së ndërmarrjen e masave sanksionuese.

Komisioni, pas rekomandimeve të Departamentit Ligjor, për shkeljet gjatë fushatës së Zgjedhjeve të Përgjithshme ka marrë masa sanksionuese ndaj këtyre OSHMA-ve:

- Klan Kosova, gjobë në shumën prej 3.000 euro;
- KTV, gjobë në shumën prej 2.000 euro;
- TV PULS, gjobë në shumën prej 2.000 euro;
- TV GRACANICA, gjobë në shumën prej 2.000 euro;
- TV MOST, gjobë në shumën prej 2.000 euro;
- TV HERC, gjobë në shumën prej 2.000 euro;
- TV DUKAGJINI, gjobë në shumën prej 4.000 euro;
- TE 7, gjobë në shumën prej 4.000 euro;
- RROKUM TV, gjobë në shumën prej 2.000 euro;
- TV 21, gjobë në shumën prej 1.000 euro;
- RKT 1, Vërejtje.

Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2019, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03

Janë proceduar tetë (8) raste:

1. Rasti i parë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Mirvete Spahija ndaj OSHMA Klan Kosova. Ankesa i referohet një kronike të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve në Klan Kosova në të cilën është trajtuar kronika “Babai ther me thikë të birin”. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se Klan Kosova me transmetimin e kësaj kronike i ka cenuar personalitetin dhe privatësinë e nënës meqë nuk kishte asnjë lloj autorizimi për të filmuar pasi që ngjarja ishte në zhvillim e sipër, dhe se pas transmetimit të kësaj kronike nënës i është renduar gjendja shëndetësore. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e kronikës dhe ka gjetur se Klan Kosova ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje Klan Kosova. Edhe pas Njoftimit për Shkelje Klan Kosova ka dështuar të veproj në pajtim me Kodin KKPM 2016/03. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë Klan Kosova me Vërejtje. Rasti është mbyllur.
2. Rasti i dytë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Naser Husaj ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikës “Dënohet avokati- avokati Naser Husaj është dënuar me burë për kallëzim penal të rrem”, të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se KTV nuk i ka ofruar hapësirën për demant ndaj transmetimit të kronikës edhe përkundër kërkesës së tij të bërë disa herë përmes email dhe telefonit duke kërkuar që t’i publikohet demanti. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. KPM i është përgjigjur përmes një shkrese palës ankuese duke e njoftuar se ka proceduar me ankesën dhe e ka njoftuar palën ankuese se KTV ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Rasti është mbyllur.

3. Rasti i tretë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Arben Shala ndaj OSHMA TV Besa. Ankesa i referohet kronikës *“Lidhja Shqiptare është mbajtur me synim që të mbroj Islamin”*, të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve në TV Besa. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se TV Besa gjatë transmetimit të kësaj kronike nuk e ka përmendur synimin e vërtetë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që ka pasur që t’i bëjë shqiptarët bashkë dhe se transmetimi i kësaj kronike nuk ka qenë asgjë tjetër veç se sulm ndaj dinjitetit propagandë me prapavijë përçarëse. Pala ankuese ka kërkuar që TV Besa duhet të kërkoj falje për të gjithë shqiptarët që janë ndier të fyer. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TV Besa nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. KPM i është përgjigjur përmes një shkrese palës ankuese duke e njoftuar se ka proceduar me ankesën dhe ka njoftuar palën ankuese se TV Besa nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Rasti është mbyllur.

4. Rasti i katërt është proceduar bazuar në Ankesën e z. Lulzim Kadriu ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikës *“Ish Drejtori në Skënderaj, Kadriu i dënua për korrupsion drejtor i zyrës ligjore në Ministrinë e Inovacionit”*, me pretendimin se gjatë transmetimit të kësaj kronike është bërë shpifje ndaj tij duke kundërshtuar lajmin sipas tij si të pavërtetë se është i dënua nga Gjykata Themelore për veprë penal të korrupsionit, duke ju shkelur të drejtat individuale, ndërhyrje në çështjet private dhe personale si dhe sulm në ndershmërinë, integritetin apo cilësinë personale si person. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së Komisioni i KPM-së mori Vendim që Ankesa e palës ankuese të refuzohet si e pabazuar. Rasti është mbyllur.

5. Rasti i pestë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Kujtim Kërveshi ndaj OSHMA First Channel. Ankesa i referohet emisionit *“Kosovë Shoë”*, me pretendimin se përmes transmetimit të këtij emisioni moderatori dhe i ftuari kanë bërë shpifje kundër Albi Shopping SH.P.K duke folur publikisht për fakte dhe deklarata të cilat janë absolutisht të pavërteta dhe të paargumentuara. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se First Channel ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje First Channel përmes të cilit i ka kërkuar që palës Ankuese t’i ofroj menjëherë të drejtën e reagimit. KPM pas njoftimit për shkelje ka gjetur se First Channel ka transmetuar reagimin e Palës ankuese duke vepruar kështu në pajtim me Kodin e Etikës KKPM 2016/03. KPM i është përgjigjur përmes një shkrese palës ankuese duke e njoftuar se ka proceduar me ankesën si dhe duke e njoftuar se First Channel ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, pasi që e ka transmetuar reagimin e palës ankuese. Rasti është mbyllur.

6. Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Familjes Istogu ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikës *“Familja Istogu kërkon azil në Suedi për djalin e sëmurë”*, të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve, me pretendimin se KTV

transmetimin e kësaj kronike e ka bërë pa autorizimin e familjes dhe për këtë familja është ndier e thyer moralisht dhe psikikisht si dhe i është shkelur privatësia, duke i zbuluar të dhëna personale për gjendjen nëpër të cilën ka kaluar dhe është duke kaluar familja dhe se për transmetimin e kësaj kronike e ka pasur autorizimin vetëm televizioni suedez. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje KTV. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim përmes të cilit kërkon nga Pala përgjegjëse që në afat prej shtatë (7) t’i kërkojë falje Palës Ankuese për transmetimin e të dhënave personale rreth gjendjes shëndetësore të djalit të tyre. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.

7. Rasti i shtatë është proceduar bazuar në Ankesën e TV EHO ndaj EMONET. Pala Ankuese përmes ankesës ka pretenduar se në zonën e tij të operimit, operatori i quajtur EMONET është duke ofruar shërbime mediale audio dhe audiovizuele pa licencë të KPM-së. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin në teren dhe nuk është konstatuar se EMONET ofron shërbime mediale audio dhe audiovizuele ashtu siç pretendon pala ankuese. KPM gjatë monitorimit në teren ka realizuar një takim me pronarin e EMONET i cili ka shprehur interesim për t’u licencuar si IPTV, prandaj është udhëzuar që të aplikoj për licencë të KPM-së nëse vendos që të ofroj shërbime mediale audio dhe audiovizuele. KPM i është përgjigjur përmes një shkrese palës ankuese duke e njoftuar se ka proceduar me ankesën dhe e ka njoftuar se EMONET nuk është gjetur duke ofruar shërbime mediale audio dhe audiovizuele. EMONET pas udhëzimeve të marra nga KPM lidhur me procedurat e marrjes së licencës ka aplikuar për licencë dhe është licencuar nga KPM.
8. Rasti i tetë është proceduar bazuar në Ankesën e BIRN ndaj OSHMA RTK 1, e përcjellur nga PZAP në KPM. Ankesa i referohet transmetimit të hapësirës së sponsorizuar nga subjekti politik LDK, të cilën RTK 1 e ka transmetuar me datë 5 tetor 2019, ditën e heshtjes zgjedhore në ora 00:24:40 pas mesnate. Pala ankuese ka pretenduar se RTK 1 ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr.03/L-073. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit të transmetuar dhe ka gjetur se RTK 1 nuk ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr 03/L-073, konkretisht nenit 52, paragrafi 1, pasi që heshtja zgjedhore ka filluar në ora 7:00 të datës 5 tetor 2019. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që Ankesa e BIRN të refuzohet si e pabazuar. Rasti është mbyllur.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge

Gjatë vitit 2019, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2018, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë, 65 dBuV/m për TV dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Territori i Republikës së Kosovës mbulohet me vetëm 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimi i rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst, KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv. Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv, në të ardhmen, është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizione me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që do të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Gjatë vitit 2019, Departamentit për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matje lidhur me vlerësimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale) me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio, në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 MHz).

DMF-ja gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njëjtë si edhe gjatë vitit paraprak që tregon se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa, niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dbuv/m. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivove, Llabjan, Parlllovë dhe Bresalc); Kaçanik – Hani i Elezit; Mitrovicë – Bajgorë; Shtime – Carralevë, Dragash – Restelicë; Prizren – Brezovicë; Kramovik – Dollc; Pejë –

Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka fare pranim të sinjalit të radiove nacionale.

Në bazë të këtyre rezultateve, është konstatuar se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, dhe Radio 21 nuk janë duke transmetuar në pajtim me parametrat teknikë siç janë të përcaktuara me Pjesën 2 të Licencës së KPM-së, ndërsa Radio Dukagjini në koordinim me KPM-në ka filluar të bëjë zgjerimin e zonës së mbulimit në tërë territorin e Kosovës.

Me gjithë rekomandimin e bërë nga ana e KPM-së, për transmetim në pajtim të plotë me parametrat teknikë të përcaktuara në Pjesën 2 të Licencës së KPM-së me qëllim të ngritjes së cilësisë së sinjalit të transmetimit si dhe shërbimin më cilësor në zonat e përcaktuara me Licencë të KPM-së, radiot nacionale nuk janë përgjigjur fare me përjashtim të Radio Dukagjinit, në lidhje me veprimet që kanë ndërmarë.

KPM-ja është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa, në bashkëpunim me ta edhe të gjenden lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra është vërtetuar se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese ishte e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e painterferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit ishte në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës. Televizionet regionale – lokale mbulojnë rreth **68.14%** të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës.

Rastet për interferencë

Gjatë vitit 2019, DMF-ja ka pranuar pesë (5) ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese radio: Radio Star (Gjilan) dhe Radio Gjilani. Lidhur me ankesën e Radio Star, për interferencë nga Radio Gjilani dhe nga Radio Rinia, pas matjeve në terren është konstatuar se Radio Gjilani dhe Radio Rinia kanë pasur probleme me sistemin e transmetimit, ku si rezultat janë shkaktuar interferenca në brezin FM. Pas rekomandimeve të KPM-së për Radio Gjilan dhe Radio Star dhe veprimeve të ndërmarra nga këto subjekte, interferencat e paraqitura janë eliminuar.

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR.

DMF-ja, gjatë vitit 2019, ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja. Gjatë vitit 2019, radiot e huaja ndërkombëtare BBC, VOA dhe RFI kanë vazhduar transmetimet e tyre. Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës. Bashkëpunimi i KPM-së me KFOR për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it. Gjatë vitit 2019, KFOR-i ka hequr dorë nga tri (3) frekuenca të cilat kanë kaluar nën menaxhim të KPM-së.

A. Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor, ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë:

Gjatë vitit 2019, TV regjionale si: TV Besa, TV Prizreni, TV Opinioni, TV Mitrovica, TV Mir, TV Most, TV Festina, TV Liria dhe TV Iliria kanë ndërprerë transmetimin tokësor pa e njoftuar KPM-në. Pas njoftimeve (rekomandimeve) nga KPM-ja për fillim të transmetimit, kanë filluar transmetimin vetëm TV Besa dhe TV Prizreni. Gjatë matjeve të vitit 2019 për TV Zoom, është konstatuar se TV ZOOM ka pranimit të sinjalit, por nuk ka përmbajtje televizive. Në aspektin e lirimt të frekuencave, në Prizren kanë hequr dorë vullnetarisht nga transmetimi Radio dhe TV Ballkani.

B. Kërkesë për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja:

Gjatë vitit 2019, pas kërkesës së Komisionit të KPM-së, DMF-ja ka bërë gjetjen e frekuencave të lira FM për lokacionet si: Prishtinë, Prizren, Pejë, Hani i Elezit, Gjakovë dhe Istog. KPM-ja ka pranuar kërkesë për frekuenca shtesë vetëm nga Radio Dukagjini, ndërsa nga radiot tjera nacionale nuk ka pasur kërkesa të tilla. Po ashtu, DMF-ja ka bërë matje në tërë territorin e Republikës së Kosovës lidhur me gjetjen dhe përditësimin e frekuencave të lira Radio FM dhe TV.

C. Plani frekuencor dhe dixhitalizimi

Gjatë vitit 2019, DMF-ja ka bërë përditësimin e planit të frekuencave për transmetim tokësor televiziv dixhital në Republikën e Kosovës, si obligim nga Ligji për Dixhitalizim në Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, janë bërë matje në terren për të verifikuar kanalet të cilat janë ndarë nga ITU për transmetim dixhital në territorin e Republikës së Kosovës. Nga këto matje është konstatuar se këto kanale nuk janë të interferuara nga vendet fqinjë.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Komisioni i Pavarur i Mediave është Organizatë Buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese, ka pasur ndryshime të Buxhetit fillestar ndaj Buxhetit final. Buxheti fillestar paraqet Buxhetin e aprovuar sipas Ligjit për ndarjet buxhetore, të ndarë sipas kategorive ekonomike.

Ndryshimet e Buxhetit fillestar ndaj Buxhetit final janë aprovuar me vendim të Qeverisë me nr. 03/115 me datë: 17.12.2019 dhe në mbështetje të nenit 15 të Ligjit të Buxhetit për vitin 2019 për kursime buxhetore.

Bazuar në këtë vendim, nga kategoria e pagave është tërhequr shuma në vlerë prej 97,773.39 €.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, Buxheti fillestar në vlerë prej 1,137,473.99 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 1,039,700.60 €.

Nga totali i Buxhetit final në vlerë prej 1,039,700.60 € është shpenzuar shuma në vlerë prej 997,819.28 € dhe Buxheti i pa shpenzuar është në vlerë prej 41,881.32 € apo 95.97 % .

Buxheti i Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2019				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe mëditjet	452,590.99	354,817.60	354,817.60	0.00
Mallra dhe Shërbime	365,383.00	365,383.00	337,056.83	28,326.17
Shërbime Komunale	28,000.00	28,000.00	19,618.85	8,381.15
Projekti Kapital	291,500.00	291,500.00	286,326.00	5,174.00
Total:	1,137,473.99	1,039,700.60	997,819.28	41,881.32

Në kategorinë e pagave dhe rrogave, Buxheti fillestar në vlerë prej 452,590.99 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 354,817.60 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 354,817.60 € apo 100%.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është paraqitur Buxheti i aprovuar në vlerë prej 365,383.00 € dhe shuma e shpenzuar në vlerë prej: 337,056.63 € si dhe Buxheti i pashpenzuar në vlerë prej 28,326.37 € apo 92.25 %.

Në kategorinë e shërbimeve komunale është paraqitur Buxheti fillestar në vlerë prej 28,000.00 € dhe shuma e shpenzuar në vlerë prej: 19,618.85 € si dhe Buxheti i pashpenzuar në vlerë prej 8,381.15 € apo 70.07%.

Në kategorinë e Projektit Kapital është paraqitur Projekti: "Përditësimi i Softuerit të Sistemit të Monitorimit". Nga Projekti i Aprovuar në vlerë prej 291,500.00 € është shpenzuar shuma në vlerë prej 286,326.00 € dhe Buxheti i pashpenzuar është në vlerë prej 5,174.00 € apo 98.23 %. Projekti ka përfunduar sipas realizimit në dy faza. Ky projekt burimin e fondeve e ka nga të Hyrat e AKP-së.

Duke u bazuar në Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2017/06, të Licencuarit nga KPM obligohen të paguajnë tarifën për licencë në baza vjetore për secilin vit fiskal. Afati për pagesën e tarifave vjetore të të licencuarve të KPM-së është data 30 qershor i vitit respektiv.

KPM, duke u bazuar në mandatin ligjor, ka mbledhur tarifën vjetore të licencës nga të licencuarit, përfshi këtu tarifën për aplikim, ndryshim dhe vazhdim të licencës të cilat sipas Ligjit për KPM-në do të duhej të plotësonin buxhetin për nevojat e KPM-së. Edhe përkundër përcaktimit ligjor se

të hyrat nga tarifa për licencë duhet ta plotësojnë buxhetin e KPM-së, deri më tani KPM-së nuk i është mundësuar alokimi dhe shfrytëzimi i këtyre mjeteve.

KPM prej tarifës së licencës për vitin 2019 ka planifikuar që të realizojë të hyra në vlerë prej 252,880.00 €.

Nga të hyrat e mbledhura prej Komisionit të Pavarur të Mediave, janë gjeneruar 218,350.70 €, prej tyre 202,614.26 € u takojnë të hyrave nga tarifa për licencë ndërsa shuma prej 432.00 € u takojnë të hyrave nga kamatat dhe shuma prej 15,304.44 € u takojnë të hyrave nga gjobat.

Në kuadër të Realizimit të të Hyrave është përfshirë vlera e të hyrave të krijuara në vitin 2019 me vlerë prej: 167,224.03 € dhe të hyrat e realizuara të viteve paraprake janë në vlerë prej 51,126.67 €. Këto të Hyra përmes llogarisë së KPM-së kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese, kemi një zvogëlim prej 4,183.46 € apo 1.92 % më pak krahasuar me të hyrat e realizuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Të gjitha obligimet nga tarifa për licencë dhe gjobat të cilat kanë statusin e të arkëtueshme në vlerë prej 687,874.28 €, janë si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës, kamatës dhe gjobave. Nga shuma totale, 500,506.01 € janë obligime financiare nga tarifa për licencë dhe 23,288.27 € nga kamatat. Ndërsa shuma në vlerë prej 164,080.00 € janë obligime nga gjobat.

Të gjitha obligimet për mos pagesën e tarifës vjetore për licencë nga viti 2011-2013 janë proceduar për ekzekutim në Gjykatën Themelore dhe për vitet 2014-2019 te përmbaruesi privat. Ndërsa, obligimet tjera financiare për mos pagesë të gjobës lidhur me vendimet e vitit 2019 janë në procedurë të ekzekutimit përmes përmbarimit privat.

Në kuadër të Ll/A në vlerë prej 687,874.28 € është e përfshirë vlera e Ll/A të krijuara në vitin 2019 me vlerë prej: 133,860.25 € dhe Ll/A të viteve paraprake 554,014.03 €.

Vlera e llogarive të arkëtueshme (LL/A) në vlerë prej 687,874.28 €, në krahasim me vitin paraprak është rritur për 83,344.00 € (604,530.28 € në vitin 2018) apo 13.79%.

Në Shtojcën III është dhënë Raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

PUNA E BORDIT PËR ANKESA

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit për KPM-në. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa, Kuvendi zgjedh Kryetarin. Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa i KPM-së, që nga 16 qershori i vitit 2019, ka vetëm një (1) anëtar, nga tre (3) sa duhet t'i ketë, pra nuk është në përbërje të plotë dhe as funksional. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 15 mars 2018, ka emëruar z. Ilaz Rudaku për anëtarë të Bordit për Ankesa me mandat tre (3) vjeçar, siç parashihet me nenin 40, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Përbërja e Bordit gjatë vitit 2019

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Avdyl	HYSENI	Kryetar	16 qershor 2016	mandat tre (3) vjeçar
Musa	DRAGUSHA	Anëtar	16 qershor 2016	mandat tre (3) vjeçar
Ilaz	RUDAKU	Anëtar	15 mars 2018	mandat tre (3) vjeçar

Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa (BA), gjatë vitit 2019, ka mbajtur pesë (5) seanca shqyrtuese, ku ka shqyrtuar pesë (5) ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së.

Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e Bordit për Ankesa ndaj Vendimeve të Komisionit të KPM-së gjatë vitit 2019 janë si në vijim:

1. Ankesa e OSHMA RTK 1 e parashtruar më datën 25 janar 2019. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur më datën 12 shkurt 2019, vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e RTK 1 dhe e vërtetoi Vendimin e Komisionit të KPM-së.
2. Ankesa e OSHMA RTK 1 e parashtruar më datën 6 mars 2019. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur më datën 29 mars 2019, vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e RTK 1 dhe e vërtetoi Vendimin e Komisionit të KPM-së.

3. Ankesa e OSHMA TE 7 e parashtruar më datën 26 prill 2019. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur më datën 10 maj 2019, vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e TE 7 dhe e vërtetoi Vendimin e Komisionit të KPM-së.
4. Ankesa e OSH IPKO e parashtruar më datën 30 prill 2019. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur më datën 10 maj 2019, vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e IPKO dhe e vërtetoi Vendimin e Komisionit të KPM-së.
5. Ankesa e Kompanisë Mediale Infokusi e parashtruar më datën 21 maj 2019. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur më datën 7 qershor 2019, vendosi sipas ankesës së Kompanisë Mediale Infokusi duke anuluar Vendimin e Komisionit të KPM-së, dhe ka marrë vendim të rishpallet konkurs publik për dhënien e licencave të reja për transmetuesit e programeve në radio, për Komunën e Prishtinës.

KPM, gjatë vitit 2019, ka pranuar edhe gjatë (6) ankesa tjera ndaj Vendimeve të Komisionit të KPM-së. Mirëpo, ka qenë e pamundur të trajtohen këto ankesa për arsye se më datë 16 qershor 2019, mandati i kryetarit Avdyl Hyseni dhe anëtarit Musa Dragusha ka skaduar. Bordi për Ankesa prej datës 16 qershor 2019, është në përbërje vetëm të anëtarit Iliaz Rudaku dhe nuk ka kuorum për trajtimin e ankesave ndaj Vendimeve të Komisionit të KPM-së.

RELIZIMI I OBJEKTIVAVE TË VITIT 2019

Sa i përket objektivës së parë, KPM-ja ka miratuar rregulloret që dalin si obligim nga Ligji për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive, ndërsa aktet tjera të planifikuara të cilat janë të ndërlidhura me Strategjinë e Dixhitalizimit nuk janë miratuar për shkak të mos miratimit të Strategjisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila Strategji është në interes nacional dhe jo vetëm i KPM-së. KPM-ja e ka dërguar Strategjinë e Dixhitalizimit për miratim tek Qeveria e Republikës së Kosovës me 16 dhjetor 2019, por Strategjia nuk është miratuar deri në përmbylljen e periudhës raportuese. Për më shumë, KPM ka dërguar disa herë në Ministrinë e Financave kërkesë për mbështetje financiare lidhur me koston e Strategjisë së Dixhitalizimit, por Ministria e Financave nuk i ka miratuar kërkesat e KPM-së lidhur me këtë çështje.

Sa i përket objektivës së dytë, KPM ka ndërmarrë disa aktivitete në këtë drejtim. Lidhur me këtë, është formuar Grupi Punues për Çështje Teknike, me përbërje nga përfaqësuesit e KPM-së dhe ekspert nga industria e mediave, i cili ka hartuar Projektin Teknik për mbulueshmërinë me sinjal dixhital të Republikës së Kosovës. Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit të KPM-së me Bankën Botërore, kjo e fundit ka hartuar një Raport “Përkrahja e dixhitalizimit në Kosovë”, me rekomandime për dixhitalizimin në Kosovë, e që do t’i shërbejë KPM-së gjatë procesit të kalimit në transmetim dixhital. Po ashtu, KPM-ja ka angazhuar edhe një kompani ndërkombëtare për hulumtimin dhe analizimin e gjendjes aktuale sa i përket procesit të dixhitalizimit. Kompania ka hartuar Raportin “Planifikimi i Rrjetit për Dixhitalizimin e Medias dhe Planin e Frekuencave për transmetimin digjital televiziv tokësor”, në të cilën janë ofruar disa rekomandime për rrugën që mund të ndiqet në kalimin në transmetim dixhital tokësor.

Sa i përket objektivit të tretë, KPM-ja ka zhvilluar disa aktivitete. Në këtë drejtim, në kuadër të projektit JUFREX, financuar dhe implementuar nga BE-ja dhe KE-ja, janë organizuar ligjërata

me nxënës të dy shkollave të mesme, një në Prishtinë dhe një në Gjilan, ku është ligjëruar dhe diskutuar lidhur me edukimin medial. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimeve me universitetin e UP-së dhe Kolegjin AAB dhe OSBE-në, KPM-ja ka mbajtur ligjërata me studentë të departamenteve të gazetarisë.

Për më shumë, KPM ka avancuar bashkëpunimin me Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, duke arritur nënshkrimin e një Memorandumi të Bashkëpunimit, me anë të së cilit janë paraparë format e bashkëpunimit në mes palëve nënshkruese, në mes tjerash edhe aktivitetet që ndërlidhen me edukimin medial.

Gjatë Javës Globale për Edukimin mbi Median dhe Informacionin, e cila shënohet çdo vit nga UNESCO, KPM-ja në bashkëpunim me INDEP, ka organizuar një tryezë diskutimi lidhur me edukimin medial, në të cilin kanë marrë pjesë ekspert nga fusha e mediave dhe OJQ-ve që kanë fushëveprimtari median, përfaqësues të mediave, OSBE, Universiteti i Prishtinës, studentë të gazetarisë etj.

Sa i përket objektivit të katërt, KPM-ja gjatë vitit 2019, në bashkëpunim dhe mbështetje financiare nga OSBE, ka realizuar një hulumtim dhe analizë të shikueshmërisë dhe dëgjueshmërisë së mediave në Kosovë. Qëllimi i hulumtimit ka qenë që KPM-ja të ketë të dhënat e fundit reale për gjendjen në terren lidhur me shikueshmërinë dhe dëgjueshmërinë për nevojat e brendshme të KPM-së, në kryerjen e detyrave të punës së përditshme.

Sa i përket objektivit të pestë, KPM-ja gjatë vitit 2019 ka vazhduar me punën në draftin e projekt Ligjit për KPM-në, proces ky që ishte iniciuar nga Komisioni Parlamentar për Media në fund të vitit 2018. KPM-ja ka ofruar kontributin e vet në procesin e amandamentimit të ligjit aktual, përmes komenteve me shkrim dhe gjatë punëtorive të zhvilluara me këtë Komision Parlamentar, por kjo çështje mbetet në proces e sipër pasi që nuk është përfunduar gjatë vitit 2019.

Po ashtu sa i përket akteve nënligjore, gjatë vitit 2019, KPM-ja ka miratuar “Rregulloren për Mbështetjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele me Mbulim Tokësor Lokal dhe Regjional” si dhe ka rishikuar dhe iniciuar amandamentimin e dy (2) akteve nënligjore, përfshirë Kodin e Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuele dhe Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale. Lidhur me këto dy akte nënligjore, janë mbajtur konsultimet publike dhe mbeten në proces të amandamentimit gjatë vitit 2020.

Lidhur me draftin e Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Mediave, i iniciuar në fund të vitit 2018, KPM-ja e ka mbajtur konsultimin publik gjatë vitit 2019 dhe kjo draft rregullore do të jetë në proces të miratimit gjatë vitit 2020.

OBJEKTIVAT E VITIT 2020

Gjatë vitit 2020, KPM-ja synon t’i arrijë objektivat e parapara si në vijim:

1. Avancimi i kornizës ligjore

- Amandamentimi i Rregullores për Shpërndarjes e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele;
- Amandamentimi i Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuele;
- Amandamentimi i Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale;
- Amandamentimi i Rregullores për Përcaktimin e Tarifës për Licencë të KPM-së;

- Miratimi i Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Mediave;

2. Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”

- Krijimi i një platforme ndërinstucionale për promovim dhe zhvillim të edukimit medial, duke definuar qartë rolin e KPM-së në këtë platformë;

3. Dixhitalizimi i shërbimeve të KPM-së (e-KPM)

- Faturimi elektronik;
- Databasa për futjen e të dhënave të aktiviteteve brenda KPM-së;
- Qasja e publikut në mënyrë elektronike;

4. Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror

- Inicimi i ndërtimit të rrjetit për transmetim dixhital në nivel shtetëror;
- Licencimi i MUX-ave në pajtim me Ligjin për Transmetim Dixhital;

Realizimi i Objektivit 4 kërkon përkrahje nga Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, meqë si projekt me karakter nacional kërkon kosto financiare. Angazhimi i institucioneve relevante të vendit, siç parashihet me Ligjin për Dixhitalizim, është element shtesë që ndikon në realizimin e këtij Objektivit.

REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT

Vështirësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare

Shkurtime të buxhetore nga Ministria e Financave pa komunikim me KPM-në dhe pa ndonjë analizë, po pamundësojnë funksionimin e KPM-së si një institucion i pavarur dhe po rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme. Gjithashtu, sfida mbetet edhe mos lejimi i shfrytëzimit të të hyrave nga tarifat vjetore të licencave siç përcaktohet me Ligjin për KPM-në, e që është element shtesë që garanton pavarësinë e institucionit.

Nevoja për rritjen e numrit të stafit

Në vazhdimësi, KPM-ja ka parashtruar kërkesa për shtimin e numrit të stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërlidhen me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM-ja është rritur dukshëm, përfshirë edhe paraqitjen e platformave të reja mediale si rezultat i zhvillimeve teknologjike, duke shtuar volumin e detyrave për nëpunësit ekzistues.

Aktualisht, KPM-ja është duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësoj edhe punën e KPM-së në zbatimin e Ligjit për KPM-në dhe atij për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore.

**AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31
DHJETOR 2018**

Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Nr	Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vlerësimi i rrezikut
1.	<p>Rekomandimi nr. 1</p> <p>Dobësi në procesin e inventarizimit të pasurisë. Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se anëtarët e komisionit për inventarizimin e pasurisë, paraprakisht janë të informuar për detyrat dhe përgjegjësitë, në mënyrë që raporti i inventarizimit të ofroj informata të sakta para përgatitjes së PVF.</p>	<p>KPM do të veproj në zbatimin e Rekomandimit duke u bazuar në Rregulloren 02/2013-Menaxhimi i Pasurisë jo financiare dhe KPM do të zbatoj procesin e inventarizimit të pasurisë në fund të vitit nga ana e Komisionit të Inventarizimit.</p>	<p>Janë marr masat për vitet në vijim.</p>	<p>I zbatuar në fund të vitit nga ana e Komisionit të Inventarizimit</p>	<p>Rekomandimi do të zbatohet duke u Bazuar në Rregulloren 02/2013.</p>
2.	<p>Rekomandimi nr. 2</p> <p>Mos aprovimi i planit strategjik. Kryetari i Komisionit duhet të kërkoj nga Zyra për Planifikim Strategjik arsyen e vonesës në kthimin e përgjigjes apo</p>	<p>KPM-ja ka përgatitur për miratim dokumentin: “Strategjia për kalim në transmetim digjital tokësor në RKS” dhe ka dërguar në Qeveri për miratim, mirëpo ende nuk është aprovuar. Strategjia nuk është aprovuar për arsye të kostos së</p>	<p>Janë marr masat për vitet në vijim.</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar.</p>	<p>Digjitalizimi është rezultat i zhvillimit tekniko - teknologjik që bart në vete afate kohore të caktuara ndërkombëtarisht për t`u realizuar. Nëse arrihet që afatet</p>

	mos dhënies së opinionit me shkrim nëse dokumenti i strategjisë mund të procedohet për miratim apo jo.	Iartë. KPM e mirëpret nga Qeveria përkrahjen dhe miratimin e Strategjisë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës.			e përcaktuara të respektohen, krijohet mundësia që qytetarët e Kosovës t'i përdorin shërbimet kualitative që i sjell Transmetimi Digjital.
--	--	--	--	--	--

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

- Rekomandimet e bartura nga viti paraprak dhe të pazbatuara, përpjekjet e bëra dhe rezultatet

Nga vlerësimet e ZKA-së për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2017, janë 6 (gjashtë) rekomandime, prej tyre vetëm 4 (katër) janë zbatuar dhe 2 (dy) rekomandime janë zbatuar pjesërisht. Rekomandimet pjesërisht të zbatuara kanë të bëjnë me:

1. Dobësitë në procesin e raportit të komisionit të inventarizimit dhe
2. Mos aprovimit të planit strategjik për transmetim dixhital. Pjesërisht është e zbatuar pasi që KPM ka përgatitur regjistrin e detajuar të rreziqeve, mirëpo edhe më tutje nuk ka arritur të sigurojë aprovimin e Strategjisë nga Qeveria.

Nga vlerësimet e ZKA-së për implementimin e rekomandimeve për vitin 2018, janë 2 (dy) rekomandime, prej tyre 1 (një) rekomandim është pjesërisht i zbatuar siç janë:

Rekomandimi 1 - është zbatuar në fund të vitit 2019 nga ana e Komisionit të Inventarizimit duke u bazuar në Rregulloren 02/2013 dhe

Rekomandimi 2 - pjesërisht i zbatuar është mos aprovimi i planit Strategjik për Transmetim Dixhital.

- Niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm të KPM-së

Nga vlerësimet e AB i MF për vitin 2018 janë dhënë 4 (katër) rekomandime, prej të cilave janë zbatuar 3 (tri) rekomandime pjesërisht dhe 1(një) rekomandim është zbatuar. Rekomandimet pjesërisht të zbatuara kanë të bëjnë me: 1. Mos aprovimin e planit strategjik për transmetim dixhital; 2. Aparatura e teknologjisë informative është e vjetruar dhe vështirëson punën e KPM-së sa i përket TI. 3. Arkëtimi i borxheve nuk është në nivel të kënaqshëm dhe Rekomandimi që është zbatuar: 4. Zyrtarët që kryejnë punë shtesë janë të pajisur me vendime.